

TRANSPARENCA DHE PËRGJEGJËSIA NË NIVEL VENDOR

VLERËSIMI I PROCESEVE TË KONSULTIMIT PUBLIK NË BASHKINË ELBASAN 2024

**PËRGATITUR NGA:
SHOQATA "TJETËR VIZION"
RRJETI PËRBALLJA E OFERTAVE POLITIKE**

Transparenca dhe Përgjegjësia në Nivel Vendor - Vlerësimi i Proceseve të Konsultimit Publik

Bashkia Elbasan

Përgatiti: Tjetër Vizion

Korrik 2024

Tabela e Përmbajtjes

TABELA E PËRMBAJTJES	2
1. LISTA E SHKURTIMEVE	3
2. HYRJE	4
3. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE E STUDIMIT	6
4. METODOLOGJIA E STUDIMIT	7
5. KUADRI LIGJOR NË NIVEL VENDOR	9
6. PËRSHKRIMI I STRUKTURËS SË QEVERISJES LOKALE NË BASHKINË ELBASAN	10
7. HISTORIKU I PROCESIT TË NJOFTIMIT DHE KONSULTIMIT PUBLIK NË BASHKINË ELBASAN	11
8. VLERËSIM I EFEKTIVITETIT DHE TRANSPARENCËS SË PROÇESIT TË KONSULTIMIT PUBLIC	13
8.1 GJETJE NGA INTERVISTAT E REALIZUARA ME STAF TË BASHKISË ELBASAN	17
8.2 GJETJE NGA INTERVISTAT E ZHVILLUARA ME ANËTARË TË KËSHILLIT BASHKIAK	21
9. PËRMBLEDHJE E KOMENTEVE DHE REKOMANDIMEVE TË GRUPEVE TË INTERESIT E QYTETARËVE NGA KONSULTIMI PUBLIC	24
9.1 INTERVISTAT E THELLUARA ME GRUPET E INTERESIT	24
9.2 PERCEPTIMI QYTETAR (PYETËSORI ONLINE)	28
10. KONKLUZIONE DHE REKOMANDIME	31
11. REFERENCA (LISTA E BURIMEVE TË PËRDORURA PËR STUDIMIN)	33
12. ANEKSE	33
ANKESI 1. KËRKESA ZYRTARE DREJTUAR BASHKISË ELBASAN	33
ANKESI 2. PYETËSORI I INTERVISTAVE TË THELLUARA ME STAFIN E BASHKISË	33
ANKESI 3. PYETËSORI I INTERVISTAVE TË THELLUARA ME GRUPET E INTERESIT	33
ANKESI 4. PYETËSORI PËR QYTETARËT ONLINE	33

1. Lista e Shkurtimeve

AMVV	Agjencia për Mbështetjen e Vetëqeverisjes Vendore
BP	Buxhetimi me Pjesëmarrje
KB	Këshilli Bashkiak
KDIMDP	Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale
KLSH	Kontrolli i Lartë i Shtetit
NED	National Endowment for Democracy
Nj.A	Njësi Administrative
NJVQV	Njësi e Vetëqeverisjes Vendore
OPIC	Olof Palme International Center
OSHC	Organizatë e Shoqërisë Civile
PBA	Projekt Buxheti Afatëmesëm
POP	Përballja e Ofertave Politike
TVO	Tjetër Vizion
VKB	Vendim i Këshillit Bashkiak

2. Hyrje

Angazhimi dhe përfshirja e qytetarëve në konsultim dhe vendimmarrje përbën një nga elementët kryesorë drejt zhvillimit të qëndrueshëm dhe qeverisjes së mirë, ku zëri i të gjithëve dëgjohet gjatë gjithë procesit të vendimmarrjes, qoftë në mënyrë të drejtpërdrejtë apo përmes organizatave të shoqërisë civile tek institucionet përgjegjëse. Pjesëmarrja aktive e qytetarëve garanton identifikimin e problemeve dhe nevojave reale, përfshirjen e njohurive dhe përvojave të të gjithë aktorëve, mbështetjen nga qytetarët në vendimmarrje duke i bërë ata të ndihen përgjegjës për çështje të përbashkëta, rritjen e besueshmërisë dhe transparencës dhe krijimin e mundësive për zgjidhje të qëndrueshme.

Roli dhe kontributi i pazëvendësueshëm i komuniteteve në proceset qeverisëse është kyç për arritjen e një qeverisjeje sa më demokratike, ndërkohë që bashkitë përmes zbatimit efektiv të ligjit dhe politikave të duhura e gjithëpërfshirëse sigurojnë zhvillim të qëndrueshëm, përfshirje dhe kohezion social.

Është misioni i qeverisjes vendore të sigurojë një administrim sa më pranë qytetarëve të saj dhe të nxisë pjesëmarrjen e tyre efektive në të, ndërkohë që ushtrimi i qeverisjes dhe përmirësimi i cilësisë së jetës nuk mund dhe nuk duhet të jenë e drejtë ekskluzive e saj. Për sa kohë që ekzistojnë mekanizma dhe modele të mirëqeverisjes, bashkitë duhet të vijojnë të kërkojnë, adaptojnë dhe praktikojnë alternativa dhe forma ku qytetarët, grupet e interes dhe shoqëria civile shihen si partnerë të domosdoshëm të këtij procesi.

Studimi zhvillohet në kuadër të vlerësimit të situatës ekzistuese në lidhje me praktikatat e njoftimit dhe konsultimit publik në nivel vendor. Ai zhvillohet nga Rrjeti “Përballja e Ofertave Politike” POP¹ në kuadër të projektit “Nxitja e Mbikëqyrjes Qytetare mbi Përgjegjshmërinë Politike” financiar nga National Endowment for Democracy dhe Olof Palme International Center.

Rrjeti POP përmes këtij programi synon të përmirësojë qeverisjen dhe përdorimin e përgjegjshëm të burimeve publike, si dhe mbrojtjes efektive të të drejtave të njeriut, nëpërmjet forcimit të kapaciteteve të OSHC-ve për të ndikuar në proceset e politikave të përfaqësuesve të tyre vendorë bashkiakë.

Organizatat anëtare të Rrjetit POP veprojnë si grupe presioni për të advokuar në qeveritë e tyre vendore për të identifikuar prioritetet e zhvillimit, në mënyrë që politikatat dhe programet të bazohen në nevojat lokale, si dhe në mundësitë dhe kapacitetet e disponueshme.

Nën këtë optikë në periudhën prill – qershor 2024, është realizuar studimi “Transparenca dhe Përgjegjësia në Nivel Vendor - Vlerësimi i Proçeseve të Konsultimit Publik”. Studimi ka për qëllim

¹ Faqe zyrtare e Rrjetit POP: <https://popNetwork.al/>

të vlerësojë situatën në 10 bashkitë e targetuara² për periudhën shtator 2023 – maj 2024, për të pasqyruar situatën e realizimit të njoftimit dhe konsultimit publik në këto njësi të qeverisjes vendore.

Gjetjet dhe rekomandimet do të shërbejnë për të marrë një informacion më të thelluar për mekanizmat e identifikuar të ligjit të njoftimit dhe konsultimit në nivel vendor, sfidat, vështirësitë dhe rastet e suksesit në zbatimin e tij.

Rrjeti POP në një fazë të mëvonshme do të punojë dhe me institucionet mbikqyrëse për të ndarë gjetjet e studimit ku përmendim, institucionin e Prefektit, Komisionerin për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale si dhe Kontrollin e Lartë të Shtetit.

Rrjeti “Përballja e Ofertave Politike – POP”, synon të rrisë debatin publik dhe informacionin te qytetarët si dhe orientimin e platformave drejt nevojave dhe prioritetëve të tyre. Përmes aktiviteteve projekti synon të forcojë demokracinë shqiptare, duke nxitur transparencën dhe llogaridhënien. Përballja e Ofertave Politike - POP, është një nismë e rrjetit të organizatave të shoqërisë civile shqiptare mbështetur nga “Olof Palme International Center” dhe “National Endowment for Democracy.”

Anëtarët e Rrjetit POP janë organizatat si më poshtë:

<ul style="list-style-type: none"> • Qendra “Aleanca Gjinore për Zhvillim”, Tiranë; • Qendra për Zhvillimin e Shoqërisë Civile, Durrës; • Qendra Rinore Vlorë, • Epoka e Re, Fier; 	<ul style="list-style-type: none"> • Intelektualët e Rinj Shpresë, Shkodër; • Lëvizja Rinore për Demokraci, Pukë; • Qendra Rinore për Progres, Kukës, • Gruaja në Zhvillim, Korçë; • Hapa të Lehtë, Vau i Dejës; • Tjetër Vizion, Elbasan
--	---

² Tiranë, Durrës, Vlorë, Pukë, Elbasan, Fier, Kukës, Shkodër, Vau i Dejës, Korçë

3. Përmbledhje Ekzekutive e Studimit

Përgatitja e këtij raporti është bërë nga Rrjeti “Përballja e Ofertave Politike” në kuadër të projektit “Nxitja e Mbikëqyrjes Qytetare mbi Përgjegjshmërinë Politike” financuar nga National Endowment for Democracy dhe Olof Palme International Center. Rrjeti POP përmes këtij programi synon të përmirësojë qeverisjen dhe përdorimin e përgjegjshëm të burimeve publike, si dhe mbrojtjes efektive të të drejtave të njeriut, nëpërmjet forcimit të kapaciteteve të OSHC-ve për të ndikuar në proceset e politikave të përfaqësuesve të tyre vendorë bashkiakë.

Në Elbasan, studimi është përgatitur nga Shoqata Tjeter Vizion³, organizatë anëtare e Rrjetit POP, me synimin kryesor që organizatat lokale të veprojnë si grupe presioni për të advokuar në qeveritë e tyre vendore për të identifikuar prioritetet e zhvillimit, në mënyrë që politikat dhe programet të bazohen në nevojat lokale, si dhe në mundësitë dhe kapacitetet e disponueshme.

Studimi “Transparenca dhe Përgjegjësia në Nivel Vendor - Vlerësimi i Proceseve të Konsultimit Publik në Elbasan” vlerësoi situatën e realizimit të ligjit të Njoftimit dhe Konsultimit Publik për periudhën shtator 2023 – maj 2024, përmes monitorimit të dëgjësive publike duke nxitur diskutimin midis aktorëve të përfshirë për njohjen dhe zbatimin e ligjit, si dhe përgatiti disa rekomandime konkrete në nivel të Njesisë së Vetëqeverisjes Vendore (NjVQV)

Pjesëmarrja e drejtpërdrejtë në vendimmarrje përfaqëson një nga format kryesor të angazhimit të qytetarëve në jetën publike. Kjo arrihet përmes mjeteve dhe mekanizmave që NJVQV ushtrojnë, në përputhje me Ligjin për Njoftimin dhe Konsultimin Publik⁴ duke vënë në dispozicion të qytetarëve, hapësira dhe mundësi për t'i përfshirë ata në formulimin, zbatimin, monitorimin dhe vlerësimin e politikave, programeve dhe shërbimeve për komunitetin. Pavarësisht se të gjithë të intervistuarit e vlerësonin rëndësinë e proceseve konsultuese dhe gjithëpërfshirëse, realizimi efektiv i tyre në nivel vendor mbetet ende një sfidë.

Mobilizimi dhe angazhimi aktiv i qytetarëve në nivel vendor, debati i hapur, ndarja dhe shkëmbimi i përvojave dhe ideve të ndryshme, si dhe shqyrtimi i të gjitha alternativave të mundshme, të realizohet në të gjitha fazat që ligji parashkon duke mundësuar një vendimmarrje të shëndetshme dhe gjithëpërfshirëse për çdo bashki.

Gjetjet e studimit tregojnë se nga 105 qytetarë që kanë plotësuar pyetësonin online, 61% e tyre kanë besim dhe bëhen pjesë e proceseve konsultuese, ndërsa 10% e tyre shprehen se nuk kanë besim, ndërsa dhe 20% e tyre, nuk janë shprehur duke mos dhënë asnjë përgjigje. Gjithashtu metodat që qytetarët informohen për konsultimin publik janë lajmerimi në faqen ëeb të bashkisë dhe regjistri elektronik. 37% e qytetarëve shprehën se kanë marrë pjesë në dëgjësat publike, ndërsa 44% e të anketuarve shprehen se nuk kanë marrë pjesë. Edhe në rastet kur kanë marrë

³ Faqe zyrtare: <https://www.tjetervizion.org/>

⁴ Ligji për Njoftimin dhe Konsultimin Publik: <https://qbz.gov.al/eli/ligj/2014/10/30/146/3923aec7-2287-4909-9119-ea5dcee6245e>

pjesë qytetarët shprehen se kanë besim se zëri i tyre do dëgjohet dhe do merren parasysh rekomandimet e tyre.

Midis krahasimit të kuadrit ligjor, formave të zbatuara dhe vlerësimeve të marra në kuadër të studimit të realizuar, vëmë re se ligji njihet dhe zbatohet mire nga ana e institucionit të bashkisë, si nga aparati ekzekutiv (stafi i bashkisë) ashtu dhe nga legjislativi (anëtarët e KB). Transparenca, konsultimi dhe pjesëmarrja qytetare në vendimmarrjen lokale vazhdojnë të jenë sfida për autoritetet vendore, duke shërbyer në të njëjtën kohë dhe si tregues të funksionimit të demokracisë lokale.

Zbatimi i Ligjit të Njoftimit dhe Konsultimit Publik duke përcaktuar qartë se cilat projekt akte i nënshtrohen detyrimisht konsultimit publik në nivel vendor duhet të qartësojë nevojën për ndryshime ligjore dhe praktika shtrënguese për moszbatimin e detyrimeve që rrjedhin nga ligji.

Gjithësesi grupet e interesit, OSHC-të lokale dhe qytetarët aktivë në komunitet duhet të rrisin kapacitetet duke njohur të drejtat e tyre për të ushtruar presion pozitiv dhe për tu ankuar pranë institucioneve përgjegjëse e duke u përballur edhe në gjykatë për çështje me intres të lartë publik.

4. Metodologjia e Studimit

Për përgatitjen e vlerësimit në lidhje me zbatimin e Ligjit të Njoftimit dhe Konsultimit publik (ligji nr. 146/2014⁵) në Bashkinë Elbasan, ekspertët e projektit kombinuan një sërë mjesh dhe metodologjish duke përfshirë:

- Analizimin e Gjetjeve të Raportit Studimor “Informimi, Njoftimi dhe Konsultimi Publik” realizuar nga Rrjeti POP në vitin 2022.⁶
- Rishikimin e dokumenteve strategjike, publikimet në regjistrin elektronik për konsultimet, publikimet në programin e transparencës, raporte të prodhuara dhe bazat e të dhënave në të gjitha fazat mbi procesin e njoftimit dhe konsultimit publik në nivel vendor;
- Hulumtimi i raporteve dhe mekanizmave të kontrollit të Prefekturës përkatëse; Kontrollit të Lartë të Shtetit si edhe të Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale (KDIMDP) për monitorimin e zbatimit të ligjit të njoftimit dhe konsultimit publik në nivel vendor.
- Kërkesa zyrtare për informacion drejtuar Kryetarit të bashkisë.
- Përgatitjen e pyetësorëve të studimit; trajnimin e intervistuesve; 10 intervista të drejtpërdrejta me stafin e bashkisë si edhe me anëtarë të këshillit bashkiak.
- 30 intervista të thelluara me aktivistë/përfaqësues të komunitetit dhe qytetarë (20 intervista me OJF, Biznese, aktiviste të shoqërisë civile dhe 10 të tjera me qytetare nga grupet e interesit); 105 pyetësorë

⁵ Ligji për Njoftimin dhe Konsultimin Publik: <https://elbasani.gov.al/wp-content/uploads/2021/09/160-2014-DI.pdf>

⁶ <https://popnetwork.al/raporti-studimor-informimi-njoftimi-dhe-konsultimi-public-bashkia-elbasan/>

online si edhe përpunimin dhe analizimin e të dhënave dhe përgatitjen e raportit përfundimtar të studimit.

Burimi kryesor i informacionit në lidhje me shqyrtimin e dokumenteve strategjike, raporteve të prodhuara dhe zbatimit të fazave të procesit të njoftimit dhe konsultimit publik janë faqja zyrtare e internetit të bashkisë e këshillit bashkiak, rregulloret e brendshme dhe publikimi i njoftimeve dhe dokumentacionit lidhur me konsultimet publike të zhvilluara, por edhe raportet e prodhuara nga institucione ndërkombëtare apo organizata të shoqërisë civile, etj.

Në periudhën prill – qershor 2024, janë intervistuar 10 (6F/4M) zyrtarë vendorë, përfaqësues të Bashkisë Elbasan dhe Këshillit Bashkiak, ndërsa janë intervistuar ballë për ballë 30 (11F/19M) përfaqësues të organizatave të shoqërisë civile dhe përfaqësues nga grupet e interesit që kanë qënë pjesë e dëgjësive publike në periudhën shtator 2023 - maj 2024. Gjithashtu një pyetësor i shpërndarë online është plotësuar nga 105 (68F/35M dhe 2 pa përgjigje) banorë të Elbasanit që kanë dhënë vlerësimin e tyre mbi njohjen e perceptimin e tyre mbi njoftimin e konsultimit publik.

Në lidhje me mekanizmat e kontrollit të zbatimit të Ligjit për Njoftimin dhe Konsultimin Publik, ekspertët dhe organizatat e përfshira në projekt kanë hulumtuar dokumentet e prodhuara nga tre institucionet që monitorojnë drejtëpërdrejtë zbatimin e ligjit për Njoftimin dhe Konsultimin Publik si institucioni i Prefektit, Kontrolli i Lartë i Shtetit dhe Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të dhënave Personale.

Për përgatitjen e studimit ekspertët e projektit hartuan kërkesa për informacion drejtuar stafeve bashkiakë të NjVQV, pyetësorë dhe intervista të thelluara me koordinatorët e Njoftimit dhe Konsultimit Publik, sekretarët e këshillave bashkiakë stafet e bashkive dhe aktivistë qytetarë e përfaqësues të OSHC-ve. Pyetësorët përmbajnë pyetje rreth temave që lidhen me: urdhërat e brendshëm për fillimin e procedurës së konsultimit publik; përgatitja dhe publikimi i kalendarit të konsultimit publik; njoftimi i konsultimit publik; realizimi i konsultimit; përgatitja dhe publikimi i procesverbaleve, ndikimi i rekomandimeve të qytetarëve dhe grupeve të interesit në vendimet përfundimtare të aprovuara nga vendimarrësit si dhe publikimi i raportit të konsultimit publik në rregjistrin elektronik. Në lidhje me qytetarët dhe grupet e interesit përmes pyetësorëve është vlerësuar efektiviteti i procesit të konsultimit publik, si reflektohen rekomandimet e tyre dhe si ndikon në jetën e qytetarëve vendimet që nuk konsultohen me proces të pjesëmarrëse.

Pyetësorët përmbajnë pyetje cilësore dhe sasiore duke mbajtur në vëmendje ekspertizën lokale të organizatave të rjetit POP, në çështje të qeverisjes vendore dhe angazhimit qytetar. Për përgatitjen e pyetësorëve ekspertët e organizatave lokale konsideruan faktorë të rëndësishëm që ndikojnë në cilësinë e sondazhit, të tilla si: objektivi i përgjithshëm i anketimit dhe konteksti lokal (të dhënat informacionet ekzistuese) për të mundësuar një kuptim më të mirë të situatës dhe çështjeve.

Gjithashtu trajnuan 10 përfaqësues të organizatave lokale, për të zhvilluar intervistat në terren. Intervistat kërkuan të sigurojnë marrjen e informacioneve në aspektin gjeografik, të moshës dhe gjinisë. Intervistuesit zhvilluan intervista të drejtpërdrejta, duke drejtuar pyetjet personalisht dhe duke plotësuar në vend pyetësorët.

Pas përfundimit të intervistave u zhvillua një bazë të dhënash, për t'u përpunuar dhe u analizuar. Shoqata Tjeter Vizion përgatiti një raport të hollësishëm të vëzhgimit me gjetjet dhe rekomandimet që do të përdoren në një fazë të mëvonshme për të avokuar për nevojat dhe prioritetet qytetarëve me përfaqësues të institucioneve vendore (Bashkia dhe KB). Ky raport është rezultat i punës intensive në zyrë dhe kontributit në terren nga përfaqësuesit e organizatave të shoqërisë civile, anëtare të rrjetit POP.

Një raport i përbashkët me gjetjet nga 10 bashkitë: Tiranë; Durrës; Elbasan; Vlorë; Fier; Vau i Dejës; Korçë; Pukë; Kukës; Shkodër do të hartohet me metodën krahasuese dhe do të shërbejë për të evidentuar progresin e arritur duke analizuar të dhënat e grumbulluara nga gjetjet, konkluzionet dhe rekomandimet e arritura nga raporte të mëparshme duke përdorur indikatorë sasiorë dhe cilësorë si burime primare⁷ dhe sekondare⁸ për grumbullimin e informacionit.

Gjetjet dhe rekomandimet e raportit do të synojnë përmirësimin e situatës aktuale nëpërmjet masave që autoritetet vendore duhet të ndër marrin në lidhje me zbatimin e ligjit dhe propozime për ndryshime ligjore për ta bërë procesin sa më interaktiv dhe gjithëpërfshirës.

5. Kuadri ligjor në nivel vendor

Misioni i NJVQV është të sigurojë një administrim sa më pranë qytetarëve dhe të nxisë një pjesëmarrje efektive të banorëve në qeverisjen vendore. Transparenca, llogaridhënia dhe përfshirja publike janë parimet themelore për ruajtjen dhe avancimin e demokracisë.

Dialogu ndërmjet qytetarëve dhe përfaqësuesve të zgjedhur, si dhe përfshirja e tyre në qeverisjen lokale, janë thelbësore për avancimin e demokracisë lokale, sepse forcohet legjitimiteti dhe efektiviteti i veprimeve të bashkisë dhe këshillit bashkiak. Procesi i konsultimit publik përbën një shtyllë kryesore për një qeverisjeje transparente, duke i mundësuar qytetarëve dhe grupeve të interesit diskutimin, dialogun, monitorimin dhe vlerësimin e punës së pushtetit vendor.

Në vëmendje të këtij studimi është njohja dhe zbatimi në Bashkinë Elbasan i Ligjit Nr. 146/2014 “Për Njoftimin dhe Konsultimin Publik” dhe Ligjit Nr.139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore” që detyrojnë organet e vetëqeverisjes vendore të garantojnë pjesëmarrjen publike në procesin e vendimmarrjes.

Legjislacioni aktual në Shqipëri përcakton detyrimin e bashkive për realizimin e njoftimit dhe konsultimit publik pothuajse për çdo vendimmarrje që ato kryejnë. Ndër ligjet kryesore që sanksionojnë detyrimin për angazhimin qytetar në vendimmarrjen lokale, më të rëndësishmit janë:

⁷ Si burimë primarë të informacionit u përdor ligji nr.146/2014, “Për Njoftimin dhe Konsultimin Publik”, informacioni në lidhje me procesin e konsultimit public të publikuar në faqet zyrtare të bashkive respektive si edhe informacioni i përfituar nëpërmjet Kërkesave për Informim.

⁸ Si burime sekondare: u përdorën raporte të tjera në lidhje me procesin e konsultimit të cilat shërbyen në përgatitjen e analizës krahasuese të progresit në çdo bashki në lidhje me procesin e konsultimit.

- Ligji Nr.146/2014 “Për Njoftimin dhe Konsultimin Publik”.
- Ligji Nr.119/2014 “Për të Drejtën e Informimit”, i ndryshuar.
- Ligji Nr. 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, i ndryshuar.
- Ligji Nr.68/2017 “Për Financat e Vetëqeverisjes Vendore”
- Ligji Nr.107/2014 “Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit”

Duke iu referuar Ligjit Nr.139/2015 për Vetëqeverisjen Vendore, bashkia si organ ekzekutiv dhe Këshilli Bashkiak si organ përfaqësues kanë detyrimin të sigurojnë transparencën e veprimtarive⁹ të tyre në procesin e vendimmarrjes.

Angazhimi i komunitetit në qeverisjen lokale, ndër të tjera, mundësohet përmes konsultimeve publike, duke sjellë në vëmendje përgjegjësitë e organeve vendore të njohin dhe zbatojnë në praktikë detyrimet që rrjedhin nga Ligji Nr. 146/2014 “Për Njoftimin dhe Konsultimin Publik”. Ky ligj rregullon marrëdhëniet për realizimin e procesit të konsultimit publik, në vendimmarrjet që i përkasin hartimit të projektakteve, të tilla si projektligje, dokumente strategjike kombëtare dhe lokale, si dhe politika me interes të lartë publik.

6. Përshkrimi i strukturës së qeverisjes lokale në bashkinë Elbasan

Informacion i përgjithshëm: Bashkia Elbasan është pjesë e Qarkut Elbasan dhe përbëhet nga 18 njësi administrative dhe 116 fshatra. Këshilli Bashkiak i Bashkisë Elbasan është i përbërë nga 51 anëtarë, nga të cilët 23 janë femra ose 45 %, çka tregon një rritje të pjesëmarrjes së grave në politike dhe vendimmarrje.¹⁰ Bashkia e realizon komunikimin e saj me qytetarët edhe nëpërmjet përfaqësimit të komunitetit në Komisionin Këshillimor Qytetar Vendor (KKQV), një grupim vullnetar dhe konsultativ me bazë të gjerë.

Bashkia Elbasan shtrihet në pjesën qendrore të Shqipërisë. Ajo është një nga Bashkitë e mëdha të vendit. Pas Reformës Administrative Territoriale Bashkia Elbasan njohu rritje drastike si në territor ashtu edhe në popullsi. Sipërfaqja e Bashkisë është 872 km² (është rritur përafërsisht 110 herë) dhe popullsia në vitin 2023 është 216.904 banorë, nga të cilët 133.637 banorë jetojnë në qytetin e Elbasanit dhe 83.267 jetojnë në Nj.A.

Këshilli Bashkiak, përbëhet nga 51 anëtarë që vijnë nga disa forca të ndryshme politike. Të ndarë sipas gjinisë janë 27 M/24 F anëtarët e KB kanë ngritur 13 komisione . Si organ përfaqësues aktualisht rregullon marrëdhëniet dhe ndërveprimin e tij me publikun përmes rregulloreve të brendshme të miratuara si më poshtë:

- *Rregullore për Organizimin dhe Funksonimin e Këshillit të Bashkisë*¹¹ .

⁹ Neni 16 dhe neni 18 i ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar.

¹⁰ Burimi: Bashkia Elbasan

¹¹ <https://elbasani.gov.al/keshilli/rregullorja-e-keshillit-bashkiak/rregullorja-e-keshillit-bashkiak-2/>

- *Rregullore për Marrëdhëniet e Këshillit Bashkiak me Publikun dhe Mediat*¹².

Bashkia Elbasan si organ ekzekutiv përmes kryetarit ka miratuar urdhëra të brendshëm që lidhen me aspektet proceduriale dhe zbatimin të Ligji Nr. 146/2014. Në rregulloren e brendshme të funksionimit dhe organizimit të administratës¹³, miratuar më 2018 nuk ka detyra specifike për koordinatorin e njoftimit dhe konsultimit publik dhe drejtori specifike që mbulon këtë pozicion.

Më poshtë listohen disa prej proceduarve dhe proceseve ku Bashkia e Elbasan dhe KB janë të detyruar të kryejnë njoftim dhe konsultim publik për qytetarët dhe grupet e interesit:

- **Konsultimeve me publikun për buxhetin vjetor, sipas ligjit Nr.68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”**
- **Këshilli bashkiak zhvillon seanca të konsultimeve me publikun për projekt dokumentin e parë të programit buxhetor afatmesëm (brenda muajit maj) dhe të projekt-buxhetit vjetor.**
- **Këshilli Bashkiak shqyrton dhe miraton projektin e parë deri te version final të programit buxhetor afatmesëm, afati nga 30 qershor – 30 shtator. Kryetari i NJQV-së dhe anëtarët e Grupit të Menaxhimit Strategjik realizojnë dëgjesa publike nga 1 shtatori – 30 nëntor, duke ftuar dhe Këshillin Bashkiak për projekt-buxhetin vjetor të vitit pasardhës.**
- **Plani i përgjithshëm vendor dhe gjithë ndryshimet që lidhen me të, proces që bëhet me konsultim publik.**
- **Ndryshim destinacioni i pronës publike, që është në inventarin e pronave të bashkisë. Vendimarrja i takon vetëm Këshillit Bashkiak, ndërsa procesi realizohet nga të dyja palët së bashku ose në mënyrë të pavarur.**
- **Dokumente të brendshme, rregullore, plane veprimi, strategji të prodhuara nga administrata e bashkisë ose nga vetë Këshilli Bashkiak, para miratimit duhet të nënshtrohen procedurës së konsultimit publik.**
- **Vendimarrje që ndikojnë direkt në jetën e qytetarëve dhe kanë efekte financiare, psh rrugë publike, parqe eolike, vendepozitim të mbetjeve, ku bashkia vendos vetë një pjesë të fondeve**

7. Historiku i procesit të njoftimit dhe konsultimit publik në bashkinë Elbasan

Informimi dhe komunikimi i vazhdueshëm në institucionet publike është një ndër elementët kryesorë për të krijuar një marrëdhënie të mirë mes institucionit dhe publikut. Institucione të ndryshme përdorin mënyra të ndryshme për të komunikuar me publikun qoftë në funksion të

¹² <https://elbasani.gov.al/rregullorja-e-konsultimeve-me-publikun/>

¹³ <https://elbasani.gov.al/bashkia/administrata/>

promovimit të aktiviteteve të tyre apo në funksion të përmbushjes për të drejtën për ndërveprim përmes konsultimit publik. Disa nga metodat e informimit dhe konsultimit që përdor Bashkia Elbasan janë si më poshtë:

Faqja Zyrtare Web e Bashkisë: Në Faqen web të Bashkisë ka një faqe të veçantë kushtuar Programit të Transparencës. Ka një Koordinator për Njoftimin dhe Konsultimin si dhe një Koordinator për të Drejtën e Informimit.

Të dhënat përkatëse të secilit koordinator gjenden në faqen e web-it ku janë të përfshira: kontaktet, numër telefoni dhe e-mail, orari i punës. Në faqen e web për informimin janë të përcaktuara procedurat për Njoftimin dhe Konsultimin Publik.

Programi Transparencës:

Gjithashtu faqja e web-it i kushton vend të vecantë Programit të Transparencës dhe ka një tabelë përmbledhëse dhe sqaruese për këdo që ka nevojë të informohet. Në përputhje me nenin 7 të ligjit nr.119/2014 “Për të Drejtën e Informimit” është përgatitur programi i transparencës për Bashkinë Elbasan. Ky program përcakton kornizën ligjore të veprimtarisë së autoritetit, në kuadër të ligjit nr.119/2014 “Për të Drejtën e Informimit” (LDI). Ky program vlerësohet si një mënyrë konkrete përmes së cilës Bashkia Elbasan ndërton dhe rrit transparencën në punën e tij institucionale, nën garancinë e LDI-së. Bashkia ka përditësuar herë pas here Programin e Transparencës, në përputhje me pikën 2 të nenit 5 të LDI-së. Informacioni i bërë publik në këtë program, synon të bëjë transparencën e veprimtarisë së punës së bashkisë, nëpërmjet pasqyrimit të detajuar të tij në faqen zyrtare www.elbasani.gov.al si dhe në mjediset e pritjes së publikut.

Programi i transparencës pasqyrohet në rubrika, tekste / përmbajtje, afat kohor për bërjen publike të tij, mënyrën e bërjes publike si dhe strukturën përkatëse, e cila prodhon ose administron dokumentin. Në përmbajtje të programit të transparencës evidentohet skema e publikimit, e cila pasqyron menutë ku adresohet dokumenti në faqen zyrtare në internet. Përveç kësaj, çdo dokument është i aksesueshëm edhe në skemë.

Në faqen e transparencës në webin e bashkisë ka një vend të veçantë për njoftimet dhe konsultimet publike me të dhënat që parashikon fusha e gjashtë e programit, ajo e pjesëmarrjes së qytetarëve në vendimarrje. Faqa e transparencës por në përgjithësi faqa e web e bashkisë është ristrukturuar sipas standarteve dhe është e aksesueshme për të gjithë.

Faqja e Programit të Transparencës së Bashkisë Elbasan është rinovuar dhe duke përmbushur të gjitha standartet dhe duke krijuar folder vec për cdo informacion, të cilet i gjeni duke klikuar në: <https://elbasani.gov.al/transparencafinalpage/>

Facebook: Bashkia Elbasan ka dhe një faqe zyrtare FB në të cilën ndahet informacioni për çdo takim, lajmerime për mbledhje, takime me publikun, takime të Kryetarit të Bashkisë, etj.

Gjithashtu facebook i kryetarit të Bashkisë Elbasan përmban një informacion të gjërë për aktivitetet e ndodhura në kohë reale të Bashkisë Elbasan.

Komunikimet e Drejtpërdrejta:

Komunikimi i drejtpërdrejtë ose ndryshe ballë për ballë është një nga mënyrat më të përdorura dhe ndoshta më të besueshme në komunikimin me qytetarët dhe transmetimin e mesazhit. Kjo pasi në këtë mënyrë bashkia dhe qytetarët kuptojnë më mirë reagimin që marrin nga njëri-tjetri. Ky lloj komunikimi është edhe një nga mënyrat që Bashkia Elbasan ka zgjedhur të komunikojë me qytetarët e saj. Gjithashtu komunikimin, Bashkia Elbasan e realizon përmes dëgjësave publike të cilat zhvillohen në institucion në ditë të caktuara, për çdo problematik apo çështje që kanë qytetarët. Në hyrje të Bashkisë janë të vendosura tabelat e njoftimeve të ndara sipas kategorisë së njoftimeve. Edhe në hyrje të NJA-ve të intervistuar ka tabela për njoftimet e publikut.

8. Vlerësim i efektivitetit dhe transparencës së procesit të konsultimit publik

Për të vlerësuar efektivitetin e transparencës së procesit të konsultimit publik, rrjeti POP bazuar në metodologjinë e studimit hartoi dhe shpërndau: (i) Kërkesë për informacion drejtuar bashkisë; (ii) realizoi intervista të thelluara me staf të bashkisë dhe anëtarë të Këshillit Bashkia; (iii) monitoroi publikimet në faqen e internetit të bashkisë dhe raporte alternative të prodhuara nga palë të treta; (iv) asistoi nga afër konsultime publike nga nxjerrja e projekt-aktit deri në miratimin përfundimtar të tij.

Rrjeti POP dhe Tjeter Vizion përgatitën një kërkesë për informacion¹⁴, ku përgjigja është dhënë brenda afateve ligjore me email¹⁵ dhe dokumentacion shkresor¹⁶. Në lidhje me informacionin mbi “Zbatimin e proceseve të ligjit të Njoftimit dhe Konsultimit Publik në Bashkinë Elbasan, për periudhën shtator 2023-maj 2024” Koordinatorin për Njoftimin dhe Konsultimin Publik për Bashkinë Elbasan bazuar në ligjin 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, ligjin nr.146/2014 “Për njoftimin dhe konsultimin publik”, vendosi në dispozicion informacionin që është pasqyuar në tabelën më poshtë.

Gjithashtu në tabelën përmbledhëse gjeni informacion të thelluar dhe mbi përgjigjet e bashkisë dhe një vlerësim shprehet me i/e realizuar plotësisht, pjesërisht, aspak. Komente rreth gjetjeve nga monitorimi janë në dispozicion të lexuesve të këtij raporti, me qëllim për të vlerësuar efektivitetin e procedurave që zbatohen nga bashkia Elbasan.

¹⁴ Kërkesë për Informim - “Zbatimi i proceseve të ligjit të Njoftimit dhe Konsultimit Publik në Bashkinë Elbasan, për periudhën shtator 2023-maj 2024” protokolluar me nr.1-8, në datën 20.05.2024

¹⁵ Kthimi i përgjigjes nga Koordinatorin i Konsultimit Publik bashkia Elbasan, me email më datë 7 maj 2024

¹⁶ Kthim përgjigjeje, nr. Prot nr.2645/1; 2643/1, më datë 07.06.2024 – dokumentacion shoqëruar shkresor, bashkia Elbasan.

Kërkesa për informacion	Pergjigjet e Bashkisë Elbasan dhe Këshilli Bashkiak	Komente / Mjetet e verifikimit	Vlerësimi
1. Emri, kontaktet e Koordinatorit të Njoftimit dhe Konsultimit Publik dhe kopje të vendimit të emërimit të tij.	Koordinatori për Njoftimin dhe Konsultimin publik në Bashkinë Elbasan është znj. Aida Talelli Email: aida.urupi@elbasani.gov.al https://elbasani.gov.al/wp-content/uploads/2021/09/kordinatori-detyrat-e-kompetencat.pdf	U.B, Kryetari i Bashkisë E njëjta punonjëse mban të dyja funksionet atë të Koordinatorit për Njoftimin dhe Konsultimin Publik dhe Koordinatortë Informimit Publik	I realizuar
2. Linkun e regjistrit elektronik ku janë publikuar projektaktet, e njoftimit për konsultim dhe të dhënave të lidhura me konsultimin e projektakteve sipas detyrimit të përcaktuar në nenin 6, pika 1, gërma a) e ligjit Nr. 146/2014 “Për njoftimin dhe konsultimin publik”;	Në përgjigjen zyrtare të bashkisë është dërguar linku i vendimeve të KB, që nuk është përgjigja e kësaj kërkesë. https://elbasani.gov.al/keshilli/rregullorja-e-keshillit-bashkiak/rregullorja-e-konsultimeve-me-publikun/ Këshilli bashkiak ka një regjistër elektronik ku janë plotësuar konsultimet që kjo strukturë ka realizuar bashkë me bashkinë ose institucione të varësisë. Më shumë në: https://elbasani.gov.al/keshilli/regjistri-elektronik/	Bashkia nuk ka një regjistër elektronik ku janë publikuar projekt-aktet për konsultim publik ka disa forma alternative ku hidhen projekt-aktet, por një regjistër i tillë nuk ekziston. Këshilli Bashkiak disponon një regjistër elektronik ku hidhen projekt aktet që ka konsultuar.	Pjesërisht i realizuar
3. Kopje të planeve vjetore të organeve publike që lidhen me procesin e vendimmarrjes, të publikuara në programin e transparencës, sipas ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”	Në seksionin e transparencës, bashkia ka publikuar planin vjetor të dëgjësive publike që ka realizuar https://elbasani.gov.al/transparencafinalpage/ https://elbasani.gov.al/kalendari-i-konsultimeve-me-publikun-per-pba/ https://elbasani.gov.al/keshilli/procesi-i-vendim-marrjes/ Edhe Këshilli Bashkiak në sesionin e transparencës në vendimmarrje publikon plane vjetore	Faqe e bashkisë përsa i përket transparencës është e organizuar shumë mirë me seksione të vecanta për çdo kategori. Bazuar në programin e transparencës ngarkohet edhe KB që të publikojë këtë plan. Aktualisht është publikuar dhe plani vjetor i punës për 2024. https://elbasani.gov.al/wp-content/uploads/2024/02/Plani-i-aktivitet-konsultimeve-buxheti-Keshilli-Bashkiak-Elbasan-2024.pdf	I realizuar
4. Mënyrat e njoftimit gjatë procesit të konsultimit publik që kryen bashkia Elbasan •me postë elektronike; •me lajmërim publik, i cili afishohet në ambientet e	Nga përgjigjet zyrtare të bashkisë Elbasan, përdoret zakonisht njoftimi me: - Mënyre elektronike të publikuara në faqen e bashkisë, - janë afishuar pranë abienteve të bashkisë - Postë elektronike - Lajmërim në mediat audiovizive rajonale ose lokale.	Nga praktika, është vënë re se njoftimet publikohen në faqen e internetit të bashkisë dhe në mediat sociale të bashkisë dhe KB.	I realizuar plotësisht

<p>organit publik inicues;</p> <ul style="list-style-type: none"> •me një lajmërim në mediat audiovizive kombëtare, rajonale ose lokale; •me botimin në gazeta lokale ose në dy gazetat më të lexuara në nivel kombëtar 			
<p>5. Mënyrat e marrjes së komenteve dhe rekomandimeve gjatë procesit të konsultimit publik</p> <ul style="list-style-type: none"> •me postë elektronike; •në formë verbale dhe/ose me shkrim e të regjistruara në procesverbalin e takimeve publike. •Tjeter 	<p>Sipas Bashkisë Elbasan, mënyrat e marrjes së komenteve janë kryesisht:</p> <ul style="list-style-type: none"> - me postë elektronike; - në formë verbale dhe/ose me shkrim e të regjistruara në procesverbalin e takimeve publike. <p>Edhe KB (sekretariati) konfirmoi të njëjtën mënyrë të marrjes së komenteve.</p> <p>https://elbasani.gov.al/keshilli/konsultime-me-publikun/</p>	<p>Nga verifikimi dokumentimi i dëgjesave që ka realizuar Bashkia Elbasan në periudhën e monitorimit, komente janë marrë me email, por zakonisht të gjitha janë të shoqëruara me procesverbalet e takimit, ku komentet/rekomandimet janë realizuar në dëgjesë. Të njëjtën procedurë ndjek dhe KB, për dëgjesat që realizon, ndërsa në takimet e monitoruara vihen re që komentet/rekomandimet mbahen edhe nga koordinatori i njoftimit dhe konsultimit publik dhe nga sekretaria e KB. Theksojmë se dëgjesat publike transmetohen live në mediat lokale, kryesisht ato të rrjeteve sociale dhe bashkëlidhen dokumentacionit shoqërues të dëgjesave që publikohet dhe në faqen e internetit të KB dhe bashkisë.</p> <p>https://elbasani.gov.al/keshilli/konsultime-me-publikun/</p>	<p>I realizuar</p>
<p>6. A ka patur raste kur është zgjatur ose përsëritur faza e konsultimit?</p>	<p>Sipas përgjigjes së bashkisë nuk ka patur raste të përsëritjes së fazës së konsultimit publik, por projektaktet te cilat kane qenë të një rëndesie të veçantë si psh dhënia në përdorim e pronës të të tretëve, për të cilët qytetarët kanë interes takimet janë zhvilluar me grupe të ndryshme ku përfshihen takime me banorë në terren dhe me grupe interesi.</p> <p>https://elbasani.gov.al/document-category/degjesa-publike/</p>		<p>Pjesërisht I realizuar</p>
<p>7. Nese Po ju lutem na dërgoni arsyet si</p>	<p>Bashkia Elbasan është përgjigjur që nuk ka patur raste.</p>		<p>i realizuar</p>

dhe kopje të aktit për të cilin është zgjatur ose përsëritur faza e konsultimit			
8. Kopje të njoftimit për takime publike	Faqja web e Bashkisë Elbasan, mediat sociale dhe urdhërat e brendshëm të Kryetarit të bashkisë. Më poshtë janë disa nga modelet si shpërndahen njoftimet për dëgjuesat publike në faqen web të Bashkisë Elbasan. https://elbasani.gov.al/pjesemarrja- qytetare/ https://elbasani.gov.al/perfshirja- qytetare/	Duke shqyrtuar dokumentacionin vendosur në dispozicion të kërkesës për informim, vihet re se janë përgatitur herë pas here UB të kryetarit të bashkisë, në disa raste njoftime në faqen e internetit dhe mediat sociale. Ndërsa KB zakonisht ndan njoftimet vetëm në mediat sociale dhe faqen e internetit.	i realizuar
9. Kopje të Proçesverbaleve të takimeve publike të zhvilluara gjatë periudhës Shtator 2023 – Maj 2024	Në linkun e mëposhtëm janë të publikuar procesverbalet e dëgjësive publike të konsultuara në periudhën e kërkuar. https://elbasani.gov.al/keshilli/konsultime-me-publikun/	Në faqen e webit të bashkisë janë publikuar gjithë procesverbalet e dëgjësive publike të realizuara nga Bashkia Elbasan. Edhe në seksionin e KB, janë publikuar procesverbalet për disa nga dëgjuesat publike të realizuar.	
10. Kopje të Projektakteve të miratuara gjatë periudhës Shtator 2023 – Maj 2024 shoqëruar me një përmbledhje të rekomandimeve të pranuar, dhe përmbledhje të arsyeve për rekomandimet e palëve të interesuara që nuk janë pranuar në zbatim të dispozitave të ligjit Nr. 146/2014 “Për njoftimin dhe konsultimin publik”	Për KB janë hedhur projektet-aktet në rregjistrin për konsultim publik të KB. https://elbasani.gov.al/keshilli/regjistri-elektronik/ Më poshtë po rendisim disa nga projekt-aktet e miratuara në KB. https://elbasani.gov.al/keshilli/llogaridhen-ja-dhe-performanca/ https://elbasani.gov.al/keshilli/projektven-dimet/ https://elbasani.gov.al/keshilli/procesi-i-vendim-marrjes/ https://elbasani.gov.al/keshilli/keshilli-dhe-keshilltare/ https://elbasani.gov.al/keshilli/procesi-i-vendim-marrjes/ https://elbasani.gov.al/akte-ligjore-dhe-nenligjore-ne-fuqi/ https://elbasani.gov.al/taksat-dhe-tarifat-vendore/	Nga përgjigjet ka analizë të projektakteve të realizuara me konsultim publik, ka informacioni që shoqërohet me një përmbledhje të rekomandimeve të pranuar, dhe vendimet e keshillit bashkiak për miratimin e rekomandimeve të qytetareve.”	I realizuar
11. Kopje të Raporti vjetor për transparencën në	Bashkëlidhur shkresës, është vënë në dispozicion kopje e raporti vjetor për	Raporti vjetor për dëgjuesat publike për vitin 2023, është vënë në dispozicion në formatin	I realizuar

procesin e vendimmarrjes per vitin 2023	transparencën në procesin e vendimmarrjes për vitin 2023. Kopje e raportit të KB për vitin 2023 https://elbasani.gov.al/raporte-te-keshillit-bashkiak/	hard-copy nga koordinatori dhe Njoftimit dhe Konsultimit Publik. KB, e ka miratuar raportin e tij në mbledhjen e muajit janar 2024.	
12. Nëse ka patur ankesa në lidhje me procesin për njoftim dhe konsultim publik. Nëse PO ju lutem na dërgoni kopje të ankesave.	Në institucion nuk ka të depozituar ankesa në lidhje me procesin për njoftimin dhe konklutimin publik	Nga qytetarët apo grupet e interesit nuk ka ankesa për procesin e realizuar në periudhën shtator 2023– maj 2024.	I realizuar


8.1 Gjetje nga intervistat e realizuara me staf të bashkisë Elbasan


Anketimi me përfaqësues të Bashkisë Elbasan përfshiu 5 nëpunës. Të intervistuarit janë punonjës të drejtorive dhe sektorëve të ndryshëm të Bashkisë Elbasan të cilët punojnë dhe kanë të bëjnë me procese që lidhen me të drejtën e informimit, njoftimin, dhe konsultimin publik me qytetarët.

Anketimi synon të evidentojë dhe sjellë në vëmendje situatën aktuale të pjesëmarrjes qytetare në proceset konsultuese dhe vendimmarrëse, si dhe të analizojë të gjitha format dhe instrumentat që përdor institucioni i Bashkisë për sjelljen më pranë të qytetarëve në bashkëqeverisje.

Në zbatim të detyrimeve të parashikuara në Ligjin 146/2014 “Për Njoftimin dhe Konsultimin Publik” në Bashki të anketuarit janë pyetur nëse ka zhvilluar bashkia juaj standartizim të procedurës administrative të njoftimit dhe konsultimit publik? (rregullore e brendshme, urdhra të brendshëm, forma standarte, verifikim). Përsa i përket pyetjes me siper 5 intervistat e kryera të 5 janë përgjigjur se ka rregullore të brendshme për konsultimin dhe njoftimin publik.

Në studim morën pjesë pesë përfaqësues të bashkisë që mbajnë role të ndryshme, ku katër ishin femra dhe një mashkull. Të gjithë të intervistuarit konfirmuan se bashkia e tyre ka standartizuar procedurën administrative të njoftimit dhe konsultimit publik, duke përfshirë rregulloret e brendshme dhe urdhrat përkatës për njoftimin dhe konsultimin publik.







Përfaqësuesit e bashkisë dhe Këshillit Bashkiak kanë deklaruar se bashkia disponon mekanizma dhe procese për pjesëmarrjen dhe konsultimin me qytetarët. Ata kanë shpjeguar se konsultimet publike realizohen për çdo vendimarrje për të cilën ligji parashikon konsultim publik, të tilla si: hartimi i buxhetit, buxhetimi me pjesëmarrje, lënia në përdorim e pronave për të tretët, dëgjesat për PPV dhe për çdo projekt të paraqitur nga drejtoritë që kërkon konsultim sipas ligjit përkatës.

Një ndër mekanizmat më efektivë, sipas të intervistuarve, është buxhetimi me pjesëmarrje. Ata e vlerësojnë si një proces ku ndërgjegjësimi i publikut për të marrë pjesë vazhdon të rritet, duke parë pjesëmarrjen e tyre në takimet e fundit. Gjithashtu, jo vetëm që interesi për pjesëmarrje është rritur, por edhe diskutimet dhe ngritja e problematikave kanë theksuar se prioriteti duhet të jetë aty ku shumica voton për të vendosur në agendat bashkiake.

Lidhur me kohëzgjatjen e realizimit të dëgjesave dhe konsultimeve publike në bashki, katër nga të intervistuarit kanë thënë se këto procese janë realizuar për më shumë se tre vjet, me një prej tyre që ka specifikuar tetë vite, ndërsa njëri ka deklaruar se këto procese janë zhvilluar për më pak se gjashtë muaj deri në një vit.



Të intervistuarit kanë përzgjedhur Këshillin Bashkiak dhe Kryetarin e Bashkisë si fillestarë të procesit të njoftimit dhe konsultimit publik. Nga ana tjetër, variantet stafi i bashkisë, organizatat jofitimprurëse dhe projektet e realizuara nga donatorë nuk janë vlerësuar nga asnjë intervistues si metoda të mundshme që kanë iniciuar njoftimin dhe konsultimin publik.



Të intervistuarit konfirmuan se ekzistojnë urdhra të brendshëm të miratuar nga Kryetari i Bashkisë dhe nga Këshilli Bashkiak për programin e transparencës. Megjithatë, asnjë i intervistuar nuk ka mundur të sigurojë një kopje elektronike të këtyre dokumenteve.

Në faqen e internetit ka informacion që është i publikuar pjesërisht, të intervistuarit janë shprehur se informacioni i publikuar ka volum të madh, dhe në shumicën e rasteve ngarkohet pjesërisht në faqen e web, por çdo person i interesuar mund të bëjë një kërkesë për informacion dhe këto dokumente ju vihen në dispozicion.

Të intervistuarit kanë përshkruar si realizohet procesi, ku pasi hartohet material publikohet në ëëbin e bashkisë, rrjetet sociale, në ambiente ku afishohen njoftimet, me email këshilltarve të Këshillit Bashkiak, ku përcaktohet dhe data dhe vendi konsultimit. Pas takimit diskutimet dhe propozimet e dala mbahen me procesverbal dhe kur janë në përputhje me ligjin reflektohen rekomandimet e dhëna në projektaktet e diskutuara në takim.


Bashkia ka një Koordinator për Njoftimin dhe Konsultimin Publik, të gjithë të intervistuarit i janë përgjigjur po ka një pozicion të tillë, personi është i emertuar si koordinator dhe të dhënat e tij i gjen lehtësisht duke klikuar në faqen ëëb të bashkisë në sesionin programi i transparencës.

Në lidhje me drejtori apo sektorë të tjerë të Bashkisë që përfshihen në proceset e njoftimit dhe konsultimit publik, të intervistuarit janë përgjigjur se në proceset e njoftimit dhe konsultimit përfshihen drejtoritë të cilat paraqesin projektaktin për konsultim duke njoftuar persona të fushës së interesuar, Këshilli Bashkiak dhe çdo drejtori që ka hartuar materialin përkatës.

Të intervistuarit shpjeguan se pjesëmarrja e publikut në vendimarrje sigurohet përmes njoftimeve publike dhe koordinatorëve përkatës të grupeve të interesit, si bizneset dhe shoqëria

civile. Njoftimet shpërndahen gjithashtu në faqen e internetit, në Facebook dhe përmes afishimeve në vendet e përcaktuara.

Të pyetur mbi mjetet që përdoren për njoftimin dhe përfshirjen e qytetarëve, të intervistuarit kanë vlerësuar si metodat më të mira për njoftimin dhe përfshirjen e qytetarëve lajmërimin në mediat sociale, lajmërimin publik të afishuar në ambientet e bashkisë dhe lajmërimin në mediat audiovizive. Më pas renditen njoftimi me regjistrin elektronik dhe posta elektronike. Botimi në gazetatat lokale është përdorur shumë rrallë nga 3 nga 5 të intervistuarit dhe është konsideruar si e papërdorur nga 2 nga 5 të intervistuarit.



Komentet dhe rekomandimet në procesin e konsultimit publik merren në formë verbale dhe/ose me shkrim e të regjistruara në procesverbalin e takimeve publike. Nga drejtoritë përkatëse përgatitet material i shkruajtur ku shpjegohen arsyet e nevojshme për nxjerrjen e projekt-aktit dhe ndikimi që do të ketë ai, kështu i vihet theksi se sa rëndësi kanë rekomandimet e tyre në përmirësimin ose funksionimin sa më të mirë të projektaktit.

Të intervistuarit kanë konfirmuar se ekziston një regjistër dhe një plan vjetor për procesin e vendimmarrjes me pjesëmarrje, i cili përfshin datat, orët dhe vendet e përcaktuara për secilin Njësi Administrative (NjA) ose lagje të Bashkisë. Regjistri përditësohet për çdo takim të ri dhe rifreskohet çdo vit në kalendarin vjetor të Këshillit Bashkiak. Një person i caktuar në sekretariatit e bashkisë është përgjegjës për përditësimin e regjistrit, i cili është i publikuar online. Nga të intervistuarit, 60% kanë deklaruar se procesverbali i takimeve mbahet dhe publikohet gjithmonë, ndërsa 40% e kanë cilësuar këtë si shpesh.

Kordinatori i konsultimit publik ka raportuar se në takimet e konsultimit publik janë përfshirë në total 2100 qytetarë, të ndarë në 1100 meshkuj dhe 900 femra. Megjithatë, për sa i përket informacionit mbi origjinën e pjesëmarrësve, si cilës Njësi Administrative (NjA) i përkasin, dhe

nëse vijnë nga organizata jofitimprurëse (OJF) ose subjekte të tjera, asnjë nga të intervistuarit nuk ka disponuar statistika të tilla.

Në lidhje me sistemin e monitorimit dhe vlerësimit të procesit të njoftimit dhe konsultimit publik, dy të intervistuar shprehen se ekziston një sistem monitorimi për këtë proces, ndërsa tre të intervistuar mendojnë se nuk ka një proces të tillë monitorimi dhe vlerësimi. Sa i përket funksionimit të këtij sistemi, asnjë nga të intervistuarit nuk ka qenë në gjendje të shpjegojë se si funksionon. Përsa i përket sfidave dhe vështirësive në zbatimin e ligjit për njoftimin dhe konsultimin publik, shumica e të intervistuarve nuk kanë raportuar sfida, ndërsa një pjesë e vogël ka përmendur vështirësi lidhur me propozimet e bëra gjatë konsultimeve me grupet e interesit, të cilat ishin përtej mundësive për t'u përfshirë në projekt-akt.

Në këndvështrimin e të intervistuarve është rritur aktivizimi i qytetarëve pas zbatimit të proceseve të infomimit dhe konsultimit, kjo pasi janë gjetur menyra më efikase për njoftimin, janë shtuar rastet e konsultimeve me publikun dhe si rrejdhojë numri i qytetarëve të interesuar për të qenë pjesë e këtyre takimeve. Gjithashtu një rol të rëndësishëm në rritjen e pjesëmarrjes së qytetarëve në këto takime ka luajtur marrja parasysh e rekomandimeve të tyre në takimet e kaluara gjë që ka rritur besimin për të qenë pjesë e takimeve. Ka gjithmonë e më shumë qytetarë që marrin pjesë në takimet konsultuese, gra dhe grupe interesi. Gjithashtu pjesëmarrësit janë gjithmonë më të përfshirë në procesin e konsultimit duke shprehur interes dhe duke qenë aktivë e duke dhënë rekomandimet e tyre në këto takime ose edhe duke kërkuar llogari për premtimet e pambajtura.

Disa nga nevojat për ta përmirësuar më tej zbatimin e procesit të njoftimit dhe konsultimit publik të intervistuarit kanë vlerësuar si më të rëndësishme burimet njerëzore, pasi pasja e personelit të nevojshëm për t'u marrë me njoftimet për konsultimet publike sjell për pasojë një pjesëmarrje më të madhe në këto takime, gjithashtu të intervistuarit vlerësojnë si të rëndësishme burimet materiale, infrastrukturën e përshtatshme, asistencë teknike dhe trajnime për personelin që merret me njoftimin dhe konsultimin, për të gjetur forma sa më efikase për të tërhequr vëmendjen e qytetarëve për të qenë pjesë e takimeve. Lidhur me rekomandimet për të përmirësuar më tej procesin e informimit dhe konsultimit me publikun të intervistuarit mendojnë si më të rëndësishme; trajnime të stafit për rritjen e ndërgjegjësimit të qytetarëve për pjesëmarrjen në proceset vendimarrëse, përmirësimi i infrastrukturës, ngritja e një platforme online ndërveprimi për të lehtësuar shkëmbimin e informacionit.

8.2 Gjetje nga intervistat e zhvilluara me anëtarë të Këshillit Bashkiak

Duke njohur dhe vlerësuar dhe rolin e kontributin e organit legjislativ (KB) në qeverisjen vendore dhe proceset pjesëmarrëse të qytetarëve, një pyetësor u përgatit dhe u shpërnda për 5 përfaqesues të KB (Aneks – formati i pyetësorit me Këshilltarët Bashkiakë).

Të pyetur mbi opinionin e tyre si këshilltarë vendor mbi përceptimin që ata kanë për rëndësinë e pjesëmarrjes së publikut dhe grupeve të interesit, në procesin e hartimit dhe vendimarrjes, të gjithë të intervistuarit shprehen se ata e konsiderojnë shumë të rëndësishëm. Së pari ata vlerësojnë shumë të rëndësishme informimin dhe njoftimin e bashkësisë për projekt-aktet që

miratojnë anëtarët e KB. Përveç se është detyrim ligjor, i shprehur dhe në rregulloret e brendshme të KB, të intervistuarit shprehen se ata kanë rritur ndjeshëm informimin ndaj qytetarëve, së pari duke trasmetuar mbledhjet e KB live, por është rritur dhe ndërveprimi me publikun, përmes publikimit e shpërndarjes në mediat sociale dhe në faqen ëeb të këshillit të çdo njoftimi për dëgjuesë publike.

Gjithashtu edhe këshillimi me bashkësinë në perceptimin e të intervistuarve ka rëndësi shumë të madhe, sepse prej takimeve, këshilltarët marrin informacion të nevojshëm për të ndërvepruar me qytetarët dhe për të marrë rekomandime e komente që janë sa më afër nevojave të komunitetit. Ata tregojnë se kanë qënë prezent në mjaft dëgjesa të organizuara nga bashkia dhe KB.

Të intervistuarit shprehen se e njohin bazën ligjore, dhe shprehen se është ligji 139 i 2015 për vetëqeverisjen vendore, rregullorja e Këshillit Bashkiak Elbasan, rregullorja për konsultimin publik. Ata mundohen të aplikojnë procedurat që parashikojnë rregulloret. Të pyetur mbi vlerësimin që ata kanë për kuadrin ligjor mbi pjesëmarrjen dhe konsultimin publik në nivel vendor 60% nga të intervistuarit kanë pohuar se ligji është i qartë dhe i plotë ndërsa 40% të tjerë të intervistuar i janë përgjigjur që ligji është i qartë por jo i plotë. Ky arsyetim sepse ligji cakton afate fikse që jo në çdo rethanë plotësohen dhe situata kërkon një vendim të përsheptuar. Do të ishte mirë që adimistrata të sjellë projektakte që kanë nevojë për konsultim, jo në momentet e fundit, por do të ishte mirë që të lihej kohë në dispozicion për dëgjuesat publike.


Siç është sqaruar në sesionet më sipër dy janë rregulloret kryesore që rregullojnë veprimtarinë e KB mbi njoftimin dhe konsultimin publik. Ato janë (1) *Rregullorja për Organizimin dhe Funksionimin e Këshillit të Bashkisë Elbasan* dhe (2) *Rregullore për Marrëdhëniet e Këshillit Bashkiak me Publikun dhe Mediat. Gjithashtu dhe Programi i Rishikuar i Transparencës.*

Në lidhje me bashkëpunimin mes Këshillit Bashkiak dhe bashkisë të gjithë këshilltarët të intervistuar mendojnë që ka. Ata shprehen se ky bashkëpunim intesifikohet në periudhën e fundvitit kur fillon puna për hartimin e buxhetit të vitit pasardhës dhe PBA-së. Për çdo projektvendim që ligji e detyron të bëhet konsultimi publik në faqen e internetit dhe mediat sociale të KB njoftohen qytetarët për të marrë pjesë. Informimi i këshilltarëve për të marrë pjesë në dëgjuesat e përbashkëta, bëhet pak ditë para dëgjuesës përmes shpërndarjes së kalendarit të dëgjuesave publike, në të cilin jepet data dhe vendi ku janë parashikuar të zhvillohen dëgjuesat.

Këshilltarët përcjellin në takimet e komisioneve ku bëjnë pjesë, prioritetet e qytetarëve që kanë mbledhur nga dëgjuesat publike, ku për ato më të rëndësishmet merret një miratim në parim për t'u vendosur në projektakt. Këshilli Bashkiak disponon infrastrukturën e duhur për realizimin dhe djekjen e proceduarve të ligjit për njoftimin dhe konsultimit publik, por në disa raste kërkohet angazhim më i madh i anëtarëve të KB.

Të pyetur mbi format e njoftimit, të intervistuarit kanë vlerësuar si mjete më të përdorura për njoftimin publik regjistrin elektronik, lajmerim publik i afishuar në ambientet e bashkisë, lajmerime në mediat sociale si facebook etj, ndërsa 3 nga të intervistuarit, rendisin si më të

rëndësishme për njoftimet e publikut si posta elektronike (e-mail), lajmërim publik i afishuar në ambientet e bashkisë, lajmërim në mediat sociale (Facebook, etj) dhe të 5 të intervistuarit kanë vlerësuar si të rëndësishëm njoftimin nëpërmjet faqes zyrtare web të bashkisë dhe si metodë që nuk përdoret fare kanë njoftim në duke e botuar në gazetën lokale.



Të gjithë të intervistuarit referojnë që këshilli ka një mekanizëm monitorimi për njoftimin dhe konsultimin publik. Nuk ka një strukturë të posaçme por ka përgjegjës konsultimi që monitoron procesin që nga publikimi i konsultimit e deri tek marrja e rekomandimeve. Ata shprehen që po raportohet mbi proceset dhe rekomandimet që dalin prej konsultimeve me publikun. Të intervistuarit shprehen që projektaktvendimet miratohen duke u vendosur si pikë e veçantë në mbledhjen e Këshillit Bashkiak, ndërsa vetëm njeri mendon se miratohen duke u përfshirë në projekt buxhetin e propozuar nga Bashkia. Të pyetur nëse ka rastë të kthimit të projektvendimeve nga KB, nëse nuk është realizuar procedura e njoftimit dhe konsultimit publik, të intervistuarit u shprehën se nuk ka patur raste të tilla, ata zakonisht gjetjet dhe rekomandimet që dalin nga ky proces mundohen ti ndjekin deri në zbatimin e tyre përfundimtar.

Nuk ka patur raste të kthimit të projektvendimeve për mos realizimin e konsultimit publik. Zakonisht rekomandimet dhe komentet që dalin nga dëgjesat publike përfshihen në projekt vendimet që përfshihen në buxhetin e propozuar nga bashkia e në disa rastë trajtohen edhe si pikë e veçantë e mbledhjeve të KB (pika të ndryshme).

Të pyetur mbi mekanizmat e pjesëmarrjes dhe konsultimit që këshilli përdor me qytetarët të intervistuarit kanë theksuar se **format** që përdorin **gjithmonë** janë: *Buxhetimi me Pjesëmarrje; faqja e internetit të KB; Mediat sociale, platformat online ose telefonatat; Tjetër – regjistrat e kërkesave, ankesave si dhe regjistri i peticioneve.*

Ndër format që përdor **shpesh** janë: *Seancat dëgjimore publike organizuar nga këshilltarët; Takimet në lagje, fshatra, njësi administrative;*

Ndër format që KB përdor **ndonjëherë** janë: *Seanca dëgjimore të Këshillit Bashkiak; Diskutime në media lokale; Komisionet këshillimore qytetare; Konsultime me ekspertë; Studimet mbi matjen e kënaqësisë së qytetarëve, pyetësorë online*

Të intervistuarit përmendin disa nga aktet ku KB dhe bashkia kanë kryer konsultime publike për periudhën shtator 2023- maj 2024 që janë të listuar në raportimin e detajuar në sesionet e mëparshme, por mund të përmendim ndryshimet në Planin Vendor; PBA dhe buxheti vjetor; konsultimi i taksave dhe tarifave vendore 2024-2025; Adminsitrim të aseteve. Shpesh KB, shpërndan dhe pyetësorë online për matjen e kënaqësisë së qytetarëve, edhe pse ky proces nuk është realizuar në periudhën e monitorimit që përfshin ky raport.


Në lidhje me sistemin e ankesave, të intervistuarit shprehen se nuk ka ankesa të rregjistruara nga qytetarët, drejtuar KB. Nuk raportohet që KB të ketë sistem të vlerësimit dhe monitorimit të mekanizmave të konsultimit publik, ndërsa çdo vit hartohet raporti i transparencës së procesve vendimarrëse. Kapacitetet e anëtarëve të KB për procedurë të njoftimit dhe konsultimit publik, vlerësohen pozitivisht, ata janë të aftë ti ndër marrin dhe ti zhvillojnë procedurat e parashikuara në rregulloret e tyre. Si sfidë ata nënvizojnë faktin se ka mungesa të stafit të trajnuar ose kapacitetet njëzore në këtë fushë janë të limituara. Sfidë është pjesëmarrja e qyterateve në konsultim, koha dhe angaxhimi që kërkon njoftimi për konsultim duke patur parasysh që janë 12 njësi dhe 6 rajone të bashkisë pra një vijë hapsinore shume e madhe. Të intervistuarit e vlerësojnë situatën mbi zbatimin e mekanizmave për angazhimin qytetar dhe konsultimin publik si mekanizma të vlefshëm duke parë se pjesëmarrja e qyterareve ka ardhur duke u rritur, por duhet akoma më shumë punë për të rritur pjesëmarrjen e qytetarëve dhe të grupeve te interesit në procesin e konsultimit publik

9. Përmbledhje e komenteve dhe rekomandimeve të grupeve të interesit e qytetarëve nga konsultimi public


9.1 Intervistat e thelluara me grupet e interesit

Anketimi me Grupet e interesit përfshiu 30 përfaqësues të OJF që operojnë në Elbasan, përfaqësues të bizneseve të ndryshme etj. Të intervistuarit kishin marrë pjesë në takimet e konsultimit dhe informimit publik, procese që lidhen me të drejtën e informimit, njoftimin, dhe konsultimin publik me qytetarët. Anketimi synon të evidentojë dhe sjellë në vëmendje situatën aktuale të pjesëmarrjes qytetare në proceset konsultuese dhe vendimmarrëse si dhe të analizojë të gjitha format dhe instrumentat që përdor institucioni i Bashkisë, përfshirë Këshilli Bashkiak Elbasan për sjelljen më pranë të qytetarëve në bashkëqeverisje.

Janë zhvilluar 30 intervista (11F/19M) me aktivistë/përfaqësues të komunitetit dhe qytetarë (12 intervista me përfaqësues të OSHC-ve (6F/6M), 8 biznese (3F/5M), 10 (3F/7M) aktivistë të shoqërisë civile dhe qytetarë nga grupet e interesit).




Të pyetur mbi informacionin që kanë mbi të drejtat e tyre për të marrë pjesë në proçet e njoftimit dhe konsultimit publik, nga 30 të intervistuar, 28 pohojnë se janë të informuar lidhur me të drejtat e tyre për të marrë pjesë në njoftimin dhe konsultimin publik që organizon Bashkia ose Këshilli Bashkiak për vendimmarrje të ndryshme që prekin jetën e komunitetit ku ata bëjnë pjesë, vetëm 2 prej tyre nuk kanë informacion.




Të pyetur mbi mjetet e përdorura nga insitucionet vendore për ti njoftuar për të marrë pjesë në dëgjesat publike shumica e të intervistuarve kanë referuar se mjetet kryesore që janë njoftuar kanë qënë: **lajmërimet individuale dhe njoftimet nga mediat sociale të bashkisë/KB**. Të tjerë të intrevistuar shprehen se janë njoftuar dhe nga adminsitratori ose kryeplaku, ndërsa disa OSHC lokale raportojnë se kanë marrë informacion nga mediat audio-vizive lokale dhe me email për pjesëmarrja për dëgjesa të ndryshme, kryesisht për plane vendore në fushën sociale të mjedisit, lajmerim i publikuar në ambientet e Bashkisë dhe si forma që nuk përdoren asnjëherë posta elektronike dhe botime në gazetata lokale

Të pyetur mbi mjetet e përdorura nga insitucionet vendore për ti njoftuar për të marrë pjesë në dëgjesat publike shumica e të intervistuarve kanë referuar se mjetet kryesore që janë njoftuar kanë qënë: **lajmërimet individuale dhe njoftimet nga mediat sociale të bashkisë/KB**. Të tjerë të intrevistuar shprehen se janë njoftuar dhe nga adminsitratori ose kryeplaku, ndërsa disa OSHC lokale raportojnë se kanë marrë informacion nga mediat audio-vizive lokale dhe me email për pjesëmarrja për dëgjesa të ndryshme, kryesisht për plane vendore në fushën sociale të mjedisit, lajmerim i publikuar në ambientet e Bashkisë dhe si forma që nuk përdoren asnjëherë posta elektronike dhe botime në gazetata lokale



Të pyetur se në cilat nga proceset konsultuese të bashkisë kanë marrë pjesë të intervistuarit janë shprehur se gjithmonë kanë marrë pjesë në dëgjesat e projekt-buxhetit për vitin 2024 si dhe në konsultimet për taksat dhe tarifat vendore, por dhe në ndryshimet për planin vendor. Përgjigjet janë dhënë kryesisht nga qytetarë aktivë dhe organizatat e biznesit që prej vitesh ndjekin proceset e mësipërme me qëllim përfaqësimin e grupeve që përfaqësojnë dhe ndikimin në fazën paraprake të vendimarrjes duke ofruar komente dhe rekomandime konkrete. Përsa i përket



OSHC-ve ato përgjigjen se ndonjëherë marrin pjesë në konsultime që kanë të bëjnë me miratimin e planeve vendore dhe/ose dëgjesa publike me grupe interesi për buxhetimin me pjesëmarrje.

Një pjesë e të intervistuarve janë shprehur se kanë dhënë rekomandime, pjesa më e madhe e të intervistuarve janë përgjigjur se asnjëherë nuk kanë dërguar komente/rekomandime të koordinatori për njoftimin dhe konsultimin publik. Ata referojnë se gjatë dëgjesave publike ata diskutojnë mbi shqetësimet e tyre dhe komentet që japin kryesisht mbeten aty dhe në pak raste këto rekomandime reflektohen në dokumentin final të projektaktit.

Të pyetur rreth bashkëpunimeve me bashkinë ose Këshillin Bashkiak për të marrë pjesë, këshilluar, ose organizuar takime publike në favor të grupit që përfaqësojnë, u vërejt se të intervistuarit që përfaqësojnë grupimet e biznesit kanë raportuar se kanë pasur bashkëpunime të tilla. Janë organizuar takime shtesë më staf të bashkisë më qëllim ndryshimin e projektakteve. Ndërkohë, pjesa e qytetarëve aktivë dhe OSHC-të, deklaruan se kanë lehtësuar pjesëmarrjen e publikut në konsultimet publike, duke shpërndarë lajmërimi, por në pjesën më të madhe të rasteve, grupet që ata përfaqësonin kanë marrë pjesë aktivisht në dëgjuesat publike. 60 % e të intervistuarve mendojnë se rekomandimet e tyre janë marrë parasysh dhe 30 % mendojnë se janë marrë parasysh pjesërisht dhe 10% mendojnë se nuk janë marrë parasysh.

Të gjithë të intervistuarit shprehen se janë shpjeguar arsyet e nevojshme për nxjerrjen e projekt-aktit, si dhe ndikimi që ai ka. Por kjo vetem me fjalë, nuk kemi patur në dorë dokumentin ose projektaktin mbi të cilin është duke u organizuar konsultimi. Në disa raste jepet vetëm informacion i përmbledhur. Kjo është një procedurë dhe qasje që duhet të ndryshojë. Ne nuk mund të marrim pjesë në dëgjuesë publike pa patur në dorë projektaktin që ka nevojë të konsultohet, shprehen nje pjese e të intervistuarve.

Në formë verbale në takime është shprehur se çdo rekomandim mund ti dërgohet bashkisë pa sqaruar në mënyre konkrete, afatin prej 20 ditësh për marrjen e komenteve/rekomandimeve dhe shumë pak persona e dinë që duhen dërguar te adresa e koordinatorit të njoftimit dhe konsultimit publik në Bashkinë Elbasan.

Koha që grupet e interesit, qytetarët dhe OSHC-të që kanë në dispozicion për të marrë pjesë në një konsultim publik në rastet kur organi publik vendos për organizimin e tij është gjithmonë e shkurtër, zakonisht njoftimi merret një ditë para ose ditën kur zhvillohet dëgjesa.

Qytetarët e pyetur nëse rekomandimet e tyre janë marrë parasysh, disa të intervistuar shprehen skeptikë, edhe pse disa prej tyre kanë arritur disa ndryshime konkrete. Ka një pjesë të mirë të të intervistuarve të cilët shprehen se rekomandimet merren parasysh por nuk shpjegojnë faktin se sa rekomandime të tyre janë marrë parasysh. Qytetarëve duhet tu krijohet mjedis mundësues nga administrata e bashkisë dhe anëtarët e KB për të arritur ndryshime reale, për tu dëgjuar dhe për të reflektuar komente konkrete në projektakte të caktuara. Të gjithë përmendin faktin se besimi publik e pjesëmarrja është në nivele te mira.

Projekt-aktet pwr konsultim jepen me vonëse 2 orë para takimit ose gjatë takimit por ka edhe raste kur nuk jepen të shkruara vetëm prezantohen nga drejtuesit, kjo gjë limiton ndjeshëm aksesin në informacion. Njohja dhe zbatimi i ligjit për njoftimin dhe konsultimin publik në pjesën më të madhe si nga administrata por dhe vetë qytetarët, ka ndikuar drejtëpërdrejtë dhe në pjesëmarrjen e qytetarëve të dëgjësave publike. Ata që njohin ligjin e njoftimit dhe konsultimit publik e këtu përmendim anëtarët e OJF, grupet e organizuara të biznesit, fitojnë epërsi ndaj grupimeve të tjera që kanë informacione të limituara dhe zbatojnë shumë pak etapat e ligjit. Nga monitorimi i dëgjësave publike dhe nga procesverbalet e dëgjësave publike, vihet re qartë që të paktën për dëgjuesën e taksave dhe tarifave vendore për 2024-2025, organizatat e biznesit kanë realizuar të gjitha etapat që parashikon ligji, kanë kërkuar marrjen e drafrit final gjatë dëgjësave, kanë organizuar takime shtesë dhe kanë dërguar dhe arsyetimin e tyre e rekomandimet me email


drejt bashkisë (jo te koordinatori) dhe në fund rekomandimet e tyre janë marrë parasysht dhe janë reflektuar në projektaktin përfundimtar që është aprovuar në KB.

Në lidhje me sfidat për njohjen dhe zbatimin e ligjit për njoftimin dhe konsultimin, pjesa më e madhe e të intervistuarve janë shprehur që ka një rritje të interesit të qytetarëve për të marrë pjesë në takimet e konsultimit publik por mbetet punë akoma nga institucionet që bëjnë njoftimet për të rritur pjesëmarrjen. Disa të intervistuar mendojnë që sfida është mungesa e interesit tek qytetarët, prandaj mendojnë ata duhen gjetur rrugë dhe forma të ndryshme për të rritur interesin e qytetarëve në takimet konsultuese. Këshillohet që ligji të njihet në të gjitha fazat e tij dhe OSHC që punojnë në territor duhet të rrisin kapacitetet e tyre dhe të ndajnë informacione të ngrenë kapacitetet e qytetarëve dhe grupeve që përfaqësojnë.

Për të përmirësuar më tej këtë proces në të ardhmen, janë propozuar disa sugjerime, ku më të rëndësishmet janë: rritja e angazhimit të institucioneve përgjegjëse për njoftimin e qytetarëve dhe grupeve të interesit, për t'u siguruar që ata të jenë pjesë aktive në këto takime.


9.2 Perceptimi qytetar (pyetësi online)

Për të mbledhur perceptimin e qytetarëve të ndryshëm në lidhje me njohuritë ose praktikën që kanë mbi njoftimin dhe konsultimin publik një pyetësor online u përgatit dhe shpërnda në 10 bashkitë ku Rrjeti POP punon. Në mediat sociale të Rrjetit dhe të organizatave lokale pyetësorët u shpërndanë me qëllimin për të matur impaktin që kanë qytetarët kanë mbi procesin. Në lidhje me pyetësorët e shpërndarë online në Elbasan janë plotësuar 105 pyetësorë (68F/35M dhe 2 pa përgjigje), nga të cilët 94 janë banorë të zonës urbane dhe 11% janë banorë të zonave rurale të Bashkisë Elbasan.




Në lidhje me moshën e pjesëmarrësve që kanë plotësuar pyetësorin online, kryesisht ai është plotësuar më së shumti nga gruposhat 15-29 vjeç dhe 30-45 vjeç, që përbëjnë dhe gruposhat më aktive në përdorimin e rrjeteve sociale. Më poshtë është pasqyruar grafikisht pjesëmarrja sipas gjinisë dhe grupmoshave që janë përfshirë në vlerësimin online.


Ndarja sipas gjinisë dhe grupmoshës sipas grafikut më poshtë tregon se pjesëmarrësit në pyetësorin online në pothuajse 50% ishin të grupmoshës 30-45 vjeç, 24% grupmosha 46-65 vjeç, 21% grupmosha 15-29 vjeç dhe 5% ishin mbi 65 vjeç.




Lidhur me pyetjen sa njohuri kanë për ligjin për konsultimin publik rezulton se mosha 46-65 vjeç kanë më tepër njohuri për ligjin të ndjekur nga mosha 30-45 dhe më pak njohuri kanë mosha 15-19 vjeç.




Pjesëmarrja në konsultimet publike të organizuara nga Bashkia apo nga Këshilli Bashkiak ka qenë më e madhe përsa i përket moshës 30-45 vjeç e ndjekur nga mosha 46-65 vjeç dhe me pak mosha 15-19 vjeç.



Përsa i përkët pyetjes se si janë njoftuar për të marrë pjesë në dëgjiesat publike qytetarët që e kanë plotësuar pyetësin online janë përgjigjur në pjesën më të madhe se njoftimin e kanë marrë nga faqa web e Bashkisë nga regjistri elektronik.



Pyetjes se a kanë besim qytetarët në përmirësimin e vendimarrjes përmes procedurave të konsultimit publik nga 105 pjesëmarrës në plotësimin e pyetësit online, 67% e qytetarëve i janë përgjigjur se kanë besim në përmirësimin e vendimarrjes, 10% e pjesëmarrësve nuk kanë besim dhe rreth 20% e pjesëmarrësve nuk i janë përgjigjur kësaj pyetje.



janë përgjigjur se kanë besim në përmirësimin e vendimarrjes, 10% e pjesëmarrësve nuk kanë besim dhe rreth 20% e pjesëmarrësve nuk i janë përgjigjur kësaj pyetje.

10. Konkluzione dhe Rekomandime

Nga analiza e pyetësoreve me përfaqësuesit e Bashkisë:

- Konsultimet publike realizohen për çdo vendimarrje për të cilin ligji parashikon konsultim publik të tilla si: hartimi i buxhetit, buxhetimi me pjesëmarrje, lënie në përdorim prona e të tretëve, dëgjesa për PPV dhe për çdo projekt të paraqitur nga drejtoritë që kërkon konsultim nga ligji përkatës.
- Buxhetimi me pjesëmarrje vlerësohet si mekanizmi që ka rezultuar më efektiv
- Në faqen e Bashkisë ka pas pak informacion të publikuar kjo për faktin se informacioni i publikuar ka volum të madh, por çdo person i interesuar mund të bëjë një kërkesë për informacion dhe këto dokumente ju vihen në dispozicion.
- Ka një regjistër dhe plan vjetor për procesin e vendimarrjes me pjesëmarrje (dëgjesat publike) dhe është i publikuar online
- Ka një plan të përgjithshëm të aktiviteteve të këshillit bashkiak në të cilin janë të përcaktuara dhe konsultimet. Ky regjistër përditesohet çdo vit, në kalendarin vjetor të KB.
- Është rritur numri i qytetarëve pasi janë gjetur mënyra më efikase për njoftimin, janë shtuar rastet e konsultimeve me publikun dhe si rrejdhojë numri i qytetarëve të interesuar për të qenë pjesë e këtyre takimeve.
- Njoftimi, informimi dhe konsultimi në vendimarrjen vendore është vlerësuar si shumë i rëndësishëm nga të gjithë të intervistuarit
- Metodatat më të përdorura për njoftimin dhe konsultimin me publikun janë njoftimi në vendet e posaçme nga Bashkia, në mediat audio vizive, në faqen web të bashkisë dhe në faqen zyrtare të FB të Bashkisë.
- Bashkia ka hartuar dhe ka të publikuar programin e transparencës dhe ka hartuar e publikuar raporte vjetore për transparencën në procesin e vendimarrjes.

Me përfaqësuesit e Këshillit Bashkiak

- Mjetet më të shpeshta që përdor Këshilli Bashkiak për njoftimin dhe informimin e publikut janë njoftimi në mediat sociale Facebook, njoftime individuale përmes postës elektronike, njoftim publik afishuar në ambjentet e Bashkisë dhe përdorim më të vogël ka njoftimi në mediat audio-vizive lokale;
- Për realizimin e njoftimit dhe konsultimit publik Këshilli Bashkiak duhet të sigurojë paraprakisht burimet e nevojshme për një pjesëmarrje gjithpërfshirëse në dëgjesat publike.
- Bashkia duhet të përditësojë vendimet e Këshillit Bashkiak pas çdo takimi (vendimet janë publikuar në faqen web të bashkisë nga marsi 2024).

- Një pjesë e mirë e anëtarëve të KB njohin mirë bazën ligjore dhe përpiqen të zbatojnë procedurat e parashikuara në rregulloret. Në zbatimin e këtyre procedurave ka pengesa në zbatimin e plotë të procedurave në praktikë.

REKOMANDIME

- Të trajnohen përfaqësuesit e Bashkisë dhe të Këshillit Bashkiak lidhur me: procedura të reja të informimit, njoftimit dhe konsultimit të publikut, mbi teknologjinë dhe përsosshmërinë në fushën dixhitale.
- Informimi dhe konsultimi i publikut të bëhet në mënyrë konstante dhe në të gjitha lagjet duke dhënë prioritet njoftimit të qytetarve, gjetjen e metodave të reja të informimit dhe rritjen e interesit të tyre për të marrë pjesë në takime.
- Njoftimet për qytetarët të bëhen sipas lagjeve dhe me frekuencë më të shpeshtë duke përdorur të gjitha kanalet e komunikimit të aksesueshme nga qytetarët.
- Të lihet koha e domosdoshme për t'u njoftuar qytetarët ose grupet e interesit për t'u përgatitur lidhur me rekomandimet për projekt-aktet që do diskutohen
- Shmangia e sjelljes së projekt-akteve për konsultim në momentet e fundit nga administrata e bashkisë, për të siguruar kohë të mjaftueshme për konsultim publik nga ana e Këshillit Bashkiak.
- Rekomandohet zhvillimi i mekanizmave të rinj për matjen e kënaqësisë së qytetarëve dhe për përmirësimin e ndërveprimit me ta.
- Këshilli Bashkiak duhet të intesifikojë fushatat e ndërgjegjësimit për rëndësinë e pjesëmarrjes qytetare në dëgjesat publike.
- Për çështje sensitive që prekin të gjithë interesat e publikut KB nuk duhet të pranojë diskutim dhe aprovim të vendimeve, pa patur një konsultim të gjërë në publik dhe në të gjithë target grupet (rritja e çmimit të ujit të pijshëm në Bashkinë Elbasan).

11. Referenca (Lista e burimeve të përdorura për studimin)

- <https://elbasani.gov.al/>
- <https://elbasani.gov.al/wp-content/uploads/2021/09/160-2014-DI.pdf>
- <https://elbasani.gov.al/keshilli/reqjistri-elektronik/>
- <https://elbasani.gov.al/keshilli/rregullorja-e-keshillit-bashkiak/rregullorja-e-konsultimeve-me-publikun/>
- <https://elbasani.gov.al/reqjistri-i-kerkesave-dhe-perqijqjeve/>
- <https://elbasani.gov.al/transparenca/>
- Programi i Transparencës të Bashkisë Elbasan
- Rregullore për Marrëdhëniet e Këshillit Bashkiak me Publikun dhe Mediat.
- Rregullore për Organizimin dhe Funksonimin e Këshillit të Bashkisë Elbasan
<https://elbasani.gov.al/keshilli/rregullorja-e-keshillit-bashkiak/rregullorja-e-keshillit-bashkiak-2/>

12. Anekse

Ankesi 1. Kërkesa zyrtare drejtuar bashkisë Elbasan

Aneksi 2. Pyetësi I Intervistave të thelluara me stafin e bashkisë

Aneksi 3. Pyetësi I intervistave të thelluara me grupet e interesit

Aneksi 4. Pyetësi për qytetarët online

Aneksi 2. Pyetësi I Intervistave të thelluara me stafin e bashkisë

VLERËSIMI I PRAKTIKAVE NJOFTIMIT DHE KONSULTIMIT PUBLIK NË NIVEL VENDOR

Kjo intervistë zhvillohet në kuadër të vlerësimit të situatës ekzistuese në lidhje me praktikën e njoftimit dhe konsultimit publik në nivel vendor. Vlerësimi zhvillohet nga Rrjeti “Përballja e Ofertave Politike” në kuadër të projektit “Nxitja e Mbikëqyrjes Qytetare mbi Përgjegjshmërinë Politike” financuar nga National Endowment for Democracy. Pyetësi ka për qëllim të vlerësojë situatën në 10 bashkitë e targetuara¹, për të pasqyruar situatën e realizimit të njoftimit dhe konsultimit publik në këto njësi të qeverisjes vendore.

Gjetjet nga intervistat do të shërbejnë për të marrë një informacion më të thelluar për mekanizmat e identifikuar të procesit të njoftimit dhe konsultimit në nivel vendor, sfidat, vështirësitë dhe faktorët e suksesit në zbatimin e tyre. Informacioni i dhënë dhe opinionet do të përdoren për përshkrimin e rasteve studimore, në kuadër të këtij studimi. Rrjeti POP, garanton pasqyrimin me korrektësi të të dhënave të marra gjatë intervistave në 10 bashkitë pilot, të identifikuara për zbatimin e mekanizmave të angazhimit qytetar dhe konsultimit në nivel vendor në Shqipëri.

Informacion i përgjithshëm për bashkinë:

Bashkia _____

Nr. i njësive administrative _____

Nr. i banorëve _____

Mbulimi territorial _____

Numri i punonjësve (F/M) _____

1. A ka zhvilluar bashkia juaj standartizim të procedurës administrative të njoftimit dhe konsultimit publik? (rregullore e brendshme, urdhra të brendshëm, forma standarte, verifikim)

Po

Jo

2. A ka zhvilluar bashkia juaj ndonjë mekanizëm apo proces të pjesëmarrjes dhe konsultimit me qytetarët? (si psh: dëgjesa publike për PPV, dëgjesa për dhënie të pronave, plane veprimi, dëgjesa për Buxhetimin me Pjesëmarrje, etj)? Nëse po, cilët janë ato për periudhën shtator 2023 – Maj 2024?

¹ Tirane, Durrës, Vlorë, Pukë, Elbasan, Fier, Kukës, Shkodër, Vau i Dejës, Korçë

3. Ndër ta, cilin do veçonit si një ndër mekanizmat që ka rezultuar më efektiv?

4. Prej sa kohësh janë realizuar dëgjesa dhe konsultime publike në bashkinë tuaj?

- Më pak se 6 muaj
- 6 muaj – 1 vit
- 1 – 3 vit
- Mbi 3 vjet (specifiko sa) _____

5. Kush i ka iniciuar procesin e njoftimit dhe konsultimit publik? (sqaro për cdo rast)

- Këshilli Bashkiak
- Kryetari i Bashkisë
- Stafi i Bashkisë
- Organizata jofitimprurëse lokale
- Projekt i realizuar me donatorë
- Tjetër (specifiko) _____

6. A ka vendime, urdhëra të brendshëm të miratuara nga Kryetari i Bashkisë apo Këshilli Bashkiak për programin e transparencës (verifikoni në disa raste është kërkuar të rishikohen programet e transparencës për 2023 - 2024?

Po Jo

7. Nëse po, ju lutem siguroni një kopje elektronike të dokumentacionit për efekt studimi, verifiko nëse plotësohen kërkesat e fushës 6 – Pjesëmarrja e Publikut në Vendimmarrje?

8. Nëse ka pak informacion dhe ato janë pjesërisht të publikuara në faqen e internetit, pse?

- Mendoni që nuk është e nevojshme
- Nuk ka kapacitete brenda bashkisë për të hartuar një dokumentacion të tillë
- Nuk keni gjetur një praktikë për t'u përshtatur në bashkinë tuaj
- Tjetër

9. Si është i organizuar procesi i njoftimit dhe konsultimit publik (hapat e procesit, përfshirë ideimin e projekt-akteve, njoftimin për konsultimin publik në regjistrin elektronik, numrin e takimeve dhe specifika për çdo takim, ku organizohen, kush merr pjesë, menaxhimi i informacionit dhe rekomandimeve nga qytetarët dhe ku reflektohen).

10. A ka bashkia juaj Koordinator për Njoftimin dhe Konsultimin Publik. Kush është përgjegjës për këtë strukturë? (saktësoni drejtorinë nga varet ky pozicion)?

11. Cilat drejtori apo sektore të tjerë të Bashkisë përfshihen në proceset e njoftimit dhe konsultimit publik?

12. Si e siguron pjesëmarrjen e gjithë grupeve të synuara në proceset me pjesëmarrje?

13. Cilat janë mjetet që përdorni për njoftimin dhe përfshirjen e qytetarëve në këtë proces? Ju lutem specifikoni shpeshësinë e përdorimit në rastin kur aplikohet.

Format e njoftimit	Gjithmonë	Shpesh	Ndonjëherë	Shumë rrallë	Asnjëherë
Regjistri elektronik	1	2	3	4	5
Posta elektronike (e-mail)	1	2	3	4	5
Lajmërim publik afishuar në ambjentet e bashkisë	1	2	3	4	5
Lajmërim në mediat audio-vizive lokale	1	2	3	4	5
Lajmërim në mediat sociale (Facebook etc)	1	2	3	4	5
Lajmërim individuale					
Botim në gazetatat lokale	1	2	3	4	5
Tjetër	1	2	3	4	5

14. Si merren komentet dhe rekomandimet në procesin e konsultimit publik në formë verbale dhe/ose me shkrim e të regjistruara në procesverbalin e takimeve publike:

- A shpjegohen arsyet e nevojshme për nxjerrjen e projekt-aktit, si dhe ndikimi që ai do të ketë? Po Jo

Afati, vendi dhe mënyra me të cilën palët e interesuara paraqesin ose dërgojnë rekomandimet e tyre? Po Jo

A afishohet/publikohet adresa e kontaktit të koordinitorit për njoftimin dhe konsultimin publik për mbledhjen e rekomandimeve e të komenteve për projektaktin?

Po Jo

A publikohet dhe kur publikohet vendi dhe data e organizimit të takimit publik në rastet kur organi publik vendos për organizimin e tij?

15. A keni regjistër ose plan vjetor për procesin e vendimmarjes me pjesmarrje (dëgjesat publike)?

Po Jo

16. Si funksionon ky regjistër/plan? A përditësohet sistematikisht? (Verifiko faqen zyrtare e internetit ku publikohen projekt-aktet, që ngarkon me përgjegjësi organet që duhet të publikojnë të gjithë procedurën e konsultimit publik të projekt-aktit)

17. Kush është përgjegjës për përditësimin e tij?

18. Është i publikuar ky regjistër/ plan vjetor(online)?

Po Jo

19. A mbahet dhe publikohet procesverbali i takimeve dhe konsultimeve me publikun?

Publikimi online	Gjithmonë	Shpesh	Ndonjëherë	Shumë rrallë	Asnjëherë
Procesverbali i takimeve	1	2	3	4	5

20. Keni statistika mbi përfshirjen e qytetarëve? Nëse po, specifikoni edhe me shifra (kjo pyetje për koordinatorin e Konsultimit Publik, drejtoritë e tjera nuk kanë statistika, thjesht merrni ndonjë ide sa informacione kanë)?

Total _____

Të ndarë sipas gjinisë _____

- Të ndarë sipas njësive administrative _____
- Organizata jofitimprurëse lokale _____
- Subjekte private _____
- Të rinj _____
- Persona të papunë _____
- Persona me nevoja të veçanta _____
- Të pastrehë _____
- Tjetër _____

21. A keni sistem monitorimi dhe vlerësimi të procesit të njoftimit dhe konsultimit publik?

Po Jo

22. Nëse po, jepni më shumë informacion mbi të (indiktorët që maten, kush është përgjegjës për monitorimin dhe vlerësimin).

23. Cilat janë disa nga sfidat dhe vështirësitë që keni ndeshur në zbatimin e ligjit për njoftimin dhe konsultimin publik në bashkinë tuaj?

24. Në këndvështrimin tuaj, a është rritur aktivizimi i qytetarëve pas zbatimit të proceseve të infomimit dhe konsultimit për ta?

25. Nëse po/jo shpjegoni si:

26. Cilat do të ishin nevojat për ta përmirësuar më tej zbatimin e këtij procesi në të ardhmen?

- Procedura
- Burime njerëzore
- Burime financiare
- Burime materiale

- Infrastrukturë e përshtatshme
- Asistencë teknike/Trajnime
- Tjetër

27. Cilat do të ishin rekomandimet tuaja për ta përmirësuar më tej zbatimin e këtij procesi në të ardhmen?

FALEMINDERIT PËR BASHKËPUNIMIN!

Rrjeti “Përballja e Ofertave Politike – POP”, synon të rrisë debatin publik dhe informacionin te qytetarët si dhe orientimin e platformave drejt nevojave dhe prioriteteve të tyre. Përmes aktiviteteve projekti synon të forcojë demokracinë shqiptare, duke nxitur transparencën dhe llogaridhënien. Përballja e Ofertave Politike - POP, është një nismë e rrjetit të organizatave të shoqërisë civile shqiptare mbështetur nga “Olof Palme International Center” dhe “National Endowment for Democracy.” Anëtarët e Rrjetit POP janë organizatat si më poshtë:

- Qendra “Aleanca Gjinore për Zhvillim”, Tiranë;
- Qendra për Zhvillimin e Shoqërisë Civile, Durrës;
- Qendra Rinore Vlorë,
- Epoka e Re, Fier;
- Intelektualët e Rinj Shpresë, Shkodër;
- Lëvizja Rinore për Demokraci, Pukë;
- Qendra Rinore për Progres, Kukës,
- Gruaja në Zhvillim, Korçë;
- Hapa të Lehtë, Vau i Dejës;
- Tjetër Vizion, Elbasan

Aneks 3. Pyetësi I intervistave të thelluara me grupet e interesit

VLERËSIMI I PRAKTIKAVE TË NJOFTIMIT DHE KONSULTIMIT PUBLIK NË NIVEL VENDOR

Kjo intervistë zhvillohet në kuadër të vlerësimit të situatës ekzistuese në lidhje me praktikën e njoftimit dhe konsultimit publik në nivel vendor. Vlerësimi zhvillohet nga Rrjeti “Përballja e Ofertave Politike” në kuadër të projektit “Nxitja e Mbikëqyrjes Qytetare mbi Përgjegjshmërinë Politike” financuar nga National Endowment for Democracy. Pyetësi ka për qëllim të vlerësojë situatën në 10 bashkitë e targetuara¹, për të pasqyruar situatën e realizimit të njoftimit dhe konsultimit publik në këto njësi të qeverisjes vendore.

Gjetjet nga intervistat do të shërbejnë për të marrë një informacion më të thelluar për mekanizmat e identifikuar të procesit të njoftimit dhe konsultimit në nivel vendor, sfidat, vështirësitë dhe faktorët e suksesit në zbatimin e tyre. Informacioni i dhënë dhe opinionet do të përdoren për përshkrimin e rasteve studimore, në kuadër të këtij studimi. Rrjeti POP, garanton pasqyrimin me korrektësi të të dhënave të marra gjatë intervistave në 10 bashkitë pilot, të identifikuar për zbatimin e mekanizmave të angazhimit qytetar dhe konsultimit në nivel vendor në Shqipëri.

Informacion i përgjithshëm për grupin e interesit:

Emri _____

Organizatë _____

Biznes _____

Aktivist _____

1. Keni informacion se ju keni të drejta si person ose përfaqësues i palëve të interesuara për të marrë pjesë në njoftimin dhe konsultimin publik që organizon bashkia/këshilli bashkiak për vendim marrje të ndryshme që prekin jetën e komunitetit?

Po Jo

2. Cilat janë mjetet që jeni njoftuar për njoftimin dhe konsultimin publik? Ju lutem specifikoni shpeshësinë e përdorimit në rastin kur aplikohet.

Format e njoftimit	Gjithmonë	Shpesh	Ndonjëherë	Shumë rrallë	Asnjëherë
Njoftime nga rregjistri elektronik/façe web bashkia	1	2	3	4	5
Posta elektronike (e-mail)	1	2	3	4	5
Lajmërim publik afishuar në ambientet e bashkisë	1	2	3	4	5

¹ Tirane, Durrës, Vlorë, Pukë, Elbasan, Fier, Kukës, Shkodër, Vau i Dejës, Korçë

Lajmërim në mediat audio-vizive lokale	1	2	3	4	5
Lajmërim në mediat sociale (Facebook, IG etj)	1	2	3	4	5
Lajmërim individuale	1	2	3	4	5
Botim në gazetat lokale	1	2	3	4	5
Tjetër, adminstratori, kryeplaku, ndërlihdësi komunitar.	1	2	3	4	5

3. Nëse po ju lutem specifikoni ku nga konsultimet e mëposhtme keni marrë pjesë ose keni kontribuar?

Format e pjesëmarrjes	Gjithmonë	Shpesh	Ndonjëherë	Shumë rrallë	Asnjëherë
Dëgjesa për projekt buxhetin vendor 2023-2024	1	2	3	4	5
Dëgjesa për taksat dhe tarifatat vendore	1	2	3	4	5
Dëgjesa për ndryshime në Planin e Përgjithshëm Vendor	1	2	3	4	5
Dëgjesa për ndryshimin/tjetërsimin ose dhënien në përodrim të pronave të të tretëve.	1	2	3	4	5
Dëgjesa për miratimin e normave, standarteve e kritere për rregullimin dhe disiplinimin e funksioneve, si dhe për mbrojtjen e garantimin e inetrësitet publik (Dëgjesa për plane veprimi vendore dhe rregullore të ndryshme)	1	2	3	4	5
Tjetër	1	2	3	4	5

4. Nëse keni marrë pjesë, a keni dhënë rekomandime/propozime për Bashkinë ose Këshillin Bashkiak me shkrim ose elektronikisht te koordinatori për njoftimin dhe konsultimin publik?

- Gjithmonë
- Ndonjëherë
- Asnjëherë

5. A keni raste bashkëpunimime bashkinë ose këshillin bashkiak për të marrë pjesë, këshilluar ose për të organizuar takime publike në favor të grupit që ju përfaqësoni?

Po

Jo

6. Nëse po, rekomandimet tuaja janë marrë parasysh?

Po

Jo

7. Kush i ka iniciuar procesin e njoftimit dhe konsultimit publik? (sqaro për cdo rast)

-
- Këshilli Bashkiak
 - Staf i Bashkisë
 - Organizata jofitimprurëse lokale
 - Projekt i realizuar me donatorë
 - Tjetër (specifiko) _____

8. Në procesin e njoftimit dhe konsultimit publik që ju keni marrë pjese në formë verbale dhe/ose me shkrim e të regjistruara në procesverbalin e takimeve publike:

- A u janë shpjeguar arsyet e nevojshme për nxjerrjen e projekt-aktit, si dhe ndikimi që ai ka?
 Po Jo

Afati, vendi dhe mënyra me të cilën, ju si palë të interesuara do të paraqesni ose dërgojnë rekomandimet tuaja?
 Po Jo

A u është treguar ose publikuar adresa e kontaktit të koordinatorit për njoftimin dhe konsultimin publik për mbledhjen e rekomandimeve e të komenteve për projektaktin?
 Po Jo

Sa kohe në dispozicion keni për të marrë pjesë në një konsultim publik në rastet kur organi publik vendos për organizimin e tij?

9. Mendoni se rekomandimet tuaja janë marrë parasysh? A besoni se konsultimet publike sjellin ndryshime reale, apo bëhen vetëm për procedurë?

10. Në konsultimet publike të organizuara a ju kanë vënë në dispozicion materiale të projekt-aktit për ta shqyrtuar dhe për të dhënë rekomandime? (Nëse po, ju lutem siguroni një kopje të dokumentacionit për efekt studimi)

11. Nëse nuk keni qënë dakord me projekt-aktin dhe keni dhënë rekomandime, komente e vërejtje, a keni patur kohë në dispozicion për ti referuar dhe cila është rruga që keni ndjekur më poshtë?

- keni përgatitur kërkesë-ankesë dhe rekomandime për ndryshim
- keni mbledhur firma të qytetarëve dhe grupeve të interesit për ta kundërshtuar
 - jeni ankuar në institucione të tjera që kanë për detyrë monitorimin e punës së bashkisë dhe vendim marrjen e kështillit bashkiak.
- keni komunikuar me mediat dhe grupet e interesit
- Tjetër

12. Cilat janë disa nga sfidat dhe vështirësitë që keni ndeshur në zbatimin e ligjit për njoftimin dhe konsultimin publik me qytetarët dhe grupet e interesit që ju përfaqësoni?

13. Në këndvështrimin tuaj, a është rritur aktivizimi i qytetarëve pas zbatimit të proceseve të infomimit dhe konsultimit për ta?

14. Nëse po/jo shpjegoni si:

15. Cilat do të ishin rekomandimet tuaja për ta përmirësuar më tej zbatimin e këtij procesi në të ardhmen?

FALEMINDERIT PËR BASHKËPUNIMIN!

Rrjeti "Përballja e Ofertave Politike – POP", synon të rrisë debatin publik dhe informacionin te qytetarët si dhe orientimin e platformave drejt nevojave dhe prioriteteve të tyre. Përmes aktiviteteve projekti synon të forcojë demokracinë shqiptare, duke nxitur transparencën dhe llogaridhënien. Përballja e Ofertave Politike - POP, është një nismë e rrjetit të organizatave të shoqërisë civile shqiptare mbështetur nga "Olof Palme International Center" dhe "National Endowment for Democracy." Anëtarët e Rrjetit POP janë organizatat si më poshtë:

- Qendra "Aleanca Gjinore për Zhvillim", Tiranë;
- Qendra për Zhvillimin e Shoqërisë Civile, Durrës;
- Qendra Rinore Vlorë,
- Epoka e Re, Fier;
- Intelektualët e Rinj Shpresë, Shkodër;
- Lëvizja Rinore për Demokraci, Pukë;
- Qendra Rinore për Progres, Kukës,
- Gruaja në Zhvillim, Korçë;
- Hapa të Lehtë, Vau i Dejës;
- Tjetër Vizion, Elbasan

Faleminderit për pjesëmarrjen në këtë anketim! Kontributi juaj është i vlefshëm për të kuptuar perceptimet publike mbi njoftimin dhe konsultimin publik në nivel vendor. Kjo anketë zhvillohet në kuadër të vlerësimit të situatës ekzistuese në lidhje me praktikën e njoftimit dhe konsultimit publik në nivel vendor. Vlerësimi zhvillohet nga Rrjeti “Përballja e Ofertave Politike” në kuadër të projektit “Nxitja e Mbikëqyrjes Qytetare mbi Përgjegjshmërinë Politike” financuar nga National Endowment for Democracy. Ai ka për qëllim të vlerësojë situatën në 10 bashkitë e targetuara (Tiranë, Durrës, Elbasan, Shkodër, Vlorë, Fier, Korçë, Kukës, Pukë, Vau Dejës) për të pasqyruar perceptimin e qytetarëve mbi njoftimin dhe konsultimin publik në këto njësi të qeverisjes vendore dhe impaktin në vendimarrje përmes konsultimit.

Ju lutemi, përgjigjuni pyetjeve të mëposhtme me sinqeritet dhe duke u bazuar në aq njohuri sa keni. Nëse keni pyetje, ju lutem kontaktoni:
perballjaeofertavepolitike@gmail.com

Seksioni A: Konsultimi Publik

A1. Bashkia:

This is a question help text.

- Durrës
- Elbasan
- Fier
- Korçë
- Kukës
- Pukë
- Shkodër
- Tiranë
- Vau i Dejës
- Vlorë

A2. 2. Gjinia:

- Femër
- Mashkull

**A3. 3. Moshë:**

- 15-29 vjeç
- 30-45 vjeç
- 46-65 vjeç
- Mbi 65 vjeç

A4. 4. Zona e banimit:

- Zonë Urbane
- Zonë Rurale

A5. 5. Keni informacion për ligjin për konsultimin publik në Shqipëri, ku procesi i njoftimit dhe konsultimit publik me qytetarët, para marrjes së vendimeve duhet të organizohet nga bashkia dhe këshilli bashkiak?

- Po
- Jo

A6. 6. A keni marrë pjesë në dëgjuesat e organizuara nga Bashkia ose Këshilli Bashkiak në dy vitet e fundit?

- Po
- Jo

A7. 7. Nëse JO, përse nuk keni qënë pjesë e konsultimeve?

Nuk e di që kam të drejtë të komentoj, të bëj vërejtje dhe ndryshime në vendimet që merr bashkia dhe/ose këshilli bashkiak.

Nuk jam i/e informuar, nuk kam njoftim se kur mbahen konsultimet publike

Nuk më intereson

Nuk marr pjesë sepse mendimet e mia nuk merren parasysh

Tjeter

Tjeter

A8. 8. Nëse PO, specifikoni si jeni vënë në dijeni të procesit?

- Njoftime nga rregjistri elektronik/faqe web e bashkisë
- Nëpërmjet postës elektronike (e-mail)
- Lajmërim i publik afishuar në ambientet e bashkisë
- Lajmërim në mediat audio-vizive lokale
- Lajmërim në mediat sociale (Facebook, Instagram, X, etj)

Lajmërimi individuale Tjetër (administratori, kryeplaku, ndërlidhësi komunitar) **A9. 9. A janë marrë në konsideratë vërejtjet/sugjerimet/komentet tuaja?**Po Jo Nuk e di Pjesërisht **A10. 10. A jeni ankuar ndonjëherë në lidhje me ndonjë aspekt të procesit të konsultimit publik?**Jo, nuk jam ankuar Po jam ankuar por nuk kam marrë përgjigje Po jam ankuar dhe kam marrë përgjigje **A11. 11. A keni besim se përmirësohet vendimarrja, në dobi të qytetarëve nëse zbatohen me përpikmëri procedurat e konsultimit publik?**Po Jo **A12. 12. Në vlerësimet e mëposhtme cilat mendoni se janë probleme të konsultimit publik?**Nuk njoftohemi në kohë në lidhje me një draft vendim që hidhet për konsultim Bashkia dhe Këshilli Bashkiak bëjnë konsultim publik formal Bashkia dhe Këshilli bashkiak nuk e bëjnë konsultimin publik me grupet e duhura të qytetarëve dhe të interesit Grupet e interesit dhe qytetarët nuk kanë mundësi për të shprehur mendimet e tyre alternative pro ose kunder në lidhje me projekt akte gjatë procesit të konsultimit publik. Edhe kur njoftohem për konsultimet publike ka pak mundësi të diskutojnë të gjithë, mungojnë materialet shoqëruese dhe nuk përcaktohen afate që pas takimeve të paraqiten vërejtjet ose argumentet e qytetarëve. Bashkia ose Këshillit Bashkiak nuk i marrin parasysh rekomandimet e dhëna nga qytetarët dhe grupet e interesit gjatë procesit të konsultimit. Nuk ka interes nga vetë qytetarët të marrin pjesë, nuk duan të përfshihen. **Faleminderit! Rrjeti POP**

RRJETI POP

Rrjeti "Përballja e Ofertave Politike – POP", synon të rrisë debatin publik dhe informacionin te qytetarët si dhe orientimin e platformave drejt nevojave dhe prioriteteve të tyre. Përmes aktiviteteve rrjeti synon të forcojë demokracinë shqiptare, duke nxitur transparencën dhe llogaridhënien. Përballja e Ofertave Politike - POP, është një nismë e rrjetit të organizatave të shoqërisë civile shqiptare mbështetur nga "Olof Palme International Center" dhe "National Endowment for Democracy."

KONTAKT

Adresa: Rr."Abdyl Frasheri", P.10/1,
Tirana, Albania

Tel: +355 (0) 422255514

Mobile: +355 69 61 20 169

Email: perballjaeofertavepolitike@gmail.com

Web: <https://popnetwork.al/>